

# EPOKA ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XIX, nr. 5677  
E mërkurë, 16 janar 2019  
çmimi 0.40 €

## Haradinaj: Nuk shfuqizohet taksa pa arritjen e marrëveshjes Kosovë - Serbi



Na ndiqni edhe në:  
[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)

facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABRUCH GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

### AKTUALE

#### KUSHTETUTA, AUTORITETI DHE PËRVOJA, TRI FUQITË E PRESIDENTIT META F. 11



Prof. Lisen BASHKURTI

#### HIPOKRIZIA NDËRKOMBËTARE DHE GJENOCIDI NË KOSOVË F. 11



Bardhyl MAHMUTI

#### GREVA NË ARSIM VAZHDON F. 7

### EKONOMI

#### BANKA BOTËRORE MBI 60 MILIONË EURO PËR PROJEKTET NË BUJQËSI F. 8

#### MBAHET DËGJIMI PUBLIK PËR AUTOSTRADËN E DUKAGJINIT F. 8

### KULTURË



#### SKËNDERBEU NË VERSION MË NDRYSHE F. 12

Ilir MUHARREMI

### SPORT

#### SHTETI KISHTE OBLIGIM TA NDËRTONTE FADIL VOKRRIN F. 20

FLET PËR "EPOKËN E RE", TALAT XHAFERI F. 4-5

## Pa shqiptarët Maqedonia nuk do t'i kishte këto të arritura



Kryetari i Kuvendit të Maqedonisë Veriore, Talat Xhaferi, ka bërë me dije se falë mbështetjes së shqiptarëve Maqedonia ka arritur në prag të anëtarësimit në NATO. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka deklaruar se pa mbështetjen e deputetëve shqiptarë nuk do të mund

të ratifikoheshin ndryshimet e nevojshme kushtetuese të parapara me marrëveshjen e Prespës e cila ia hapi perspektivën euroatlantike Maqedonisë. Kryeparlamentari i Maqedonisë ka vlerësuar se ka vepruar në bazë të kompetencave kushtetuese kur ka nënshkruar Ligjin

për përdorimin e gjuhëve. Kreu i Kuvendit të Maqedonisë ka mohuar mundësinë që tani ky shtet të shkojë në zgjedhje të parakohshme. Sipas Xhaferit, Maqedonia nuk e ka luksin të shkojë në zgjedhje në kohën e nisjes së negociatave për integrimet euroatlantike

## Kosova hap zyrën doganore në Portin e Durrësit

Dogana e Kosovës ka hapur të martën zyrën doganore në Portin e Durrësit. Kjo zyrë është cilësuar nga përfaqësuesit e Kosovës dhe të Shqipërisë si hap që do t'i rrisë shkëmbimet tregtare ndërmjet dy shteteve. Shkëmbimet tregtare përmes Portit të Durrësit pritet ta shkurtojë koston e shpenzimeve të transportit, kohën si dhe zbutjen e procedurave burokratike tregtare. Zëvendëskryeministri Fatmir Limaj ka thënë se ky është projekti më i rëndësishëm konkret në mes të Kosovës dhe Shqipërisë F. 9



## Masakra e Reçakut, themel i lirisë dhe pavarësisë së Kosovës

F. 7

**RENOVA**  
PUTZ  
Maqedoni  
Xhepcisht-Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**Kolegji BIZNESI**  
www.kolegijbiznesi.com  
info@kolegijbiznesi.com  
038 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERALBANK VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302  
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

**DINO**  
Konjuh Lipjan, Magj. Prishtinë Ferizaj-Kosovë  
tel & fax +381 38 566 666

# Greva në arsim vazhdon

Greva në institucionet e arsimit në Kosovë vazhdon. Si pasojë e grevës procesi mësimor është ndërprerë në të gjitha nivelet e shkollimit, duke filluar nga institucionet parashkollore e deri tek institucionet e arsimit universitar



grevën e përgjithshme. Kryetari Jasharaj, i shoqëruar nga nënkryetarja e BSPK-së, Lokaj dhe bashkëpunëtorët, vizituan grevistët në Shkollën Filllore të Mesme të Ulët "Elena Gjika". "Ju dëshmuat se jemi bashkë duke na dhënë forcë për angazhime", ka thënë Jasharaj, duke bërë me dije se dialogu me institucionet e ven-

dit nuk ka dhënë rezultate, prandaj punëtorët e arsimit vendosën për grevën e përgjithshme. Grevistët lavdëruan punën e SBASHK-ut, në veçanti të kryetarit, duke kërkuar që ai të vazhdojë me këtë përkushtim. Sipas raporteve të arritura në Këshillin Qendror Grevist nga e tërë Kosova në grevë ishin të

gjithe të punësuarit në sektorin e arsimit. Greva do të vazhdojë edhe në ditët në vazhdim nga ora 9:00 deri në orën 12:00. Sipas kalendarit, mësimi ishte dashur të fillonte më 14 janar. Kjo grevë është organizuar nga Sindikata e Bashkuar e Arsimit, e Shkencës dhe e Kulturës. Kërkesa kryesore e grevistëve ka të bëjë me rritjen e pagave. Kjo rritje po kërkohet të realizohet përmes koeficientit të pagave, që pritet të rregullohet me Ligjin për pagat i cili aktualisht, në formën e projektligjit, është në procedurë të miratimit në Kuvendin e Kosovës. Koeficienti i mësimdhënësve të arsimit fillor dhe të mesëm aktualisht, sipas SBASHK-ut, është 2 deri në 2.3 me pagë mesatare nga 420 deri në 440 euro, kurse kërkohet që ky koeficient të rritet në 2.6, respektivisht 3, që i bie paga mujore të arrijë në rreth 650 euro.

**EPOKA E RE** **Faton DËRMAKU**

**PRISHTINË, 15 JANAR** - Edhe në ditën e dytë, greva e përgjithshme është mbajtur në të gjitha institucionet e arsimit, nga çerdhet e deri tek universitetet. Në ditën e dytë të grevës, Rrahman Jasharaj, kryetar i Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Kulturës (SBASHK) me anëtarë të tjerë të Këshillit Qendror Grevist ka vizituar çerdhen "Lulevera" dhe ka bashkëbiseduar me grevistët të cilët kanë kërkuar nga Jasharaj që greva të mos ndërpritet pa u plotësuar në tërësi kërkesat

legjitime të anëtarësisë. Jasharaj i ka informuar grevistët për rrjedhën e ditës së parë të grevës dhe për takimet që kishte me institucionet në përpjekje për të gjetur zgjidhje të kërkesave. Pas kësaj nënkryetarja e BSPK-së, Leonora Lokaj, ka përshëndetur grevistët, duke shprehur përkrahjen e fuqishme të BSPK-së për punëtorët e arsimit. Ajo ka kujtuar se SBASHK-u është munduar që përmes dialogut të bëhet korigjimi i koeficienteve për tërë sektorin e arsimit, por dialogu dhe këto angazhime nuk kanë dhënë rezultatet e pritura, prandaj u detyrua ta shpallë

## NATO-ja diskuton për formimin e ushtrisë së Kosovës



**BRUKSEL, 15 JANAR** - Shefat e mbrojtjes të NATO-s do të takohen të martën dhe të mërkurën për të diskutuar në lidhje me misionet e Aleancës në Afganistan dhe në Kosovë. Siç raporton agjencia spanjolle e lajmeve "EFE", pjesë e diskutimeve do të jetë edhe çështja e formimit të Ushtrisë së Kosovës, kundër rekomandimeve të Aleancës Veriatlantike. Siç raporton kjo agjenci, debati për Kosovën pritet të zhvillohet

sot (e mërkurë), ku pritet të dalin edhe me "rekomandime", transmeton Koha.net. Në muajin dhjetor, NATO-ja tha se do të vazhdojë me misionin e saj paqeruajtës në Kosovë për të garantuar sigurinë, pavarësisht vendimit të autoriteteve këtu për të krijuar ushtrinë, por thanë se do të "rishikojnë" raportet me Kosovën. "NATO-ja, si një aleancë, ka punuar shumë që të mbajë rajonin të sigurt për më shumë

se 18 vjet përmes misionit të KFOR-it, i cili tani ka rreth 4,000 trupa, dhe përmes asistencës sonë dhe këshillave, që ndihmojnë në ndërtimin e kapaciteteve të Forcës së Sigurisë së Kosovës dhe institucioneve civile", ka thënë presidenti i Komitetit Ushtarak të NATO-s, Mareshali britanik Stuart Peach. Britaniku ka insistuar po ashtu se "siguria dhe stabiliteti i Ballkanit Perëndimor mbeten të rëndësishme për NATO-n".

## Zaevi dhe Ahmeti do të vendosin për kandidat të përbashkët presidencial

**SHKUP, 15 JANAR** - VMRO-DPMNE duhet të marrë guximin dhe të marrë pjesë në zgjedhjet presidenciale, edhe pse sigurisht që do të humbasin. Kështu ka thënë deputeti i BDI-së Artan Grubi, lidhur me paralamërimet e VMRO-DPMNE-së për bojkotin e mundshëm të zgjedhjeve parlamentare. Grubi ka thënë se gjatë këtij muaji udhëheqësi i BDI-së, Ali



Ahmeti duhet të takohet me kryeministrin Zoran Zaev dhe të bien dakord mbi kandidatin e përbashkët për president.

"Gjatë këtij muaji, pas pushimeve, Ahmeti do të takohet me Zaevin për të diskutuar për zgjedhjet presidenciale. Bindjet tona janë të ngjashme dhe lehtë mundë të arrijmë marrëveshje për kandidat të përbashkët, i cili do t'i përfaqësojë më së miri qytetarët dhe do të përfaqësojë kohezionin e vërtetë të shoqërisë", ka thënë Grubi.

## Forumi Crans Montana do të mbahet këtë vit në Kosovë

**PRISHTINË, 15 JANAR** - Ministri i Punëve të Jashtme, Behgjet Pacolli, ka zhvilluar të martën një takim me presidentin e Forumit Crans Montana, Pierre Emmanuel Quirin. "Sipas idesë dhe propozimit tim jemi dakorduar për organizimin e Forumit prestigjioz botëror Crans Montana në Kosovë gjatë këtij viti. Kosova do të jetë



nikoqire e kësaj ngjarje të madhe të nivelit ndërkombëtar", ka shkruar Pacolli në llogarinë e vet në "Facebook".

## Vuçiçi dhe Putini do të diskutojnë për Kosovën

**BEOGRAD, 15 JANAR** - Presidenti serb, Aleksandar Vuçiçi tha se pret që gjatë vizitës së presidentit rus, Vladimir Putin në Serbi më 17 janar, të nënshkruhen 21 marrëveshje për të ardhmen e Serbisë

dhe se çështja e Kosovës do të jetë pjesë e diskutimeve. Në një intervistë për mediet serbe, ai tha se është thelbësore për Beogradin të sqarohet vrasja e kreut të Iniciativës Qytetare, Oliver

Ivanović, por autoritetet e Serbisë nuk mund të kryenin një hetim në vendngjarje dhe nuk kanë pranuar materialet e kërkuara. Vuçiçi shtoi se ai u tha shërbimeve serbe, që të mos paraqisnin të

gjitha njohuritë para përvjetorit. "Ivanović u vra në ditën kur ishin zgjedhjet e Beogradit, a do të ishte e përshtatshme për dikë në Beograd kjo, vetëm nëse dikush është i çmendur", tha Vuçiçi.



Është mbajtur mbledhja e radhës e Qeverisë së Republikës së Kosovës

# Haradinaj: Nuk shfuqizohet taksa pa arritjen e marrëveshjes Kosovë - Serbi



Taksën ndaj produkteve serbe do ta mbajmë deri në vitin 2022 nëse nuk ka marrëveshje për njohje ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. Kështu ka deklaruar të martën kryeministri Ramush Haradinaj në një konferencë për medie. Ai ka bërë me dije se ka pranuar një kërkesë nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës për pezullimin e taksës ndaj produkteve serbe por, pavarësisht prej kërkesës së miqve amerikanë, taksa mbetet në fuqi. Haradinaj ka treguar se klima e krijuar me taksën nuk është e përshtatshme që ai t'i vizitojë Shtetet e Bashkuara të Amerikës për Lutjet e Mëngjesit

**EPOKA  
ERE****Shqipe HETEMI**

**PRISHTINË, 15 JANAR** - Kryeministri i Republikës së Kosovës, Ramush Haradinaj, të martën ka bërë me dije se taksa ndaj produkteve serbe nuk do të shfuqizohet pa nënshkrimin e marrëveshjes përfundimtare Kosovë - Serbi e cila do të rezultojë me njohjen e ndërsjellë. Në një konferencë për media pas mbledhjes së Qeverisë, Haradinaj ka thënë se taksa mund të zgjasë deri në vitin 2022

deri kur, sipas tij, Serbia po përpiqet t'i zvarrisë negociatat. "Nëse shkruhet një kontratë për një marrëveshje gjithëpërfshirëse dhe duhet të shkojmë aty për ta vendosur firmën e jap mundësinë që të pezullojmë për aq ditë sa zgjatë ajo mundësi për t'u nënshkruar. Nuk është qëllimi që me taksë ta bllokojmë nënshkrimin e marrëveshjes për njohje. Serbia mendon të shkojë deri në vitin 2022 për aplikim në Bashkimin Evropian dhe ne do ta mbajmë taksën deri në 2022 nëse nuk ka

marrëveshje për njohjen", ka deklaruar Haradinaj.

Shefi i kabinetit qeveritar ka treguar se ka pranuar një kërkesë nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës (ShBA) për pezullimin e taksës prej 100 përqindësh ndaj produkteve serbe por, pavarësisht prej kërkesës së miqve amerikanë, Haradinaj ka thënë se taksa mbetet në fuqi. "Ata duhet të tregojnë vetë se nuk kemi të drejtë t'i përmendim qëndrimet e tyre, mirëpo për interes të publikut po tregoj se po, kemi marrë një kërkesë. Dashurinë ndaj Amerikës e kemi pa kushte dhe besnikëria është e vërtetë. I kemi disa punë tona të shtëpisë që do t'i kryejmë për interesa tonat. S'kam ardhur këtu për përshtatje, i marr disa rreziqe për t'i arritur disa qëllime të mëdha", është shprehur ai.

Megjithatë, kryeministri Haradinaj ka bërë me dije se klima e krijuar me taksën nuk është e përshtatshme që ai t'i vizitojë Shtetet e Bashkuara të Amerikës për Lutjet e Mëngjesit. I pyetur për vizitën në ShBA, Haradinaj ka theksuar se ka pranuar ftesë për Lutje të mëngjesit,

por se nuk do të shkojë atje. "Me këtë klimë me taksën nuk shkoj kësaj here, por duhet pritur të shkoj më vonë", ka theksuar Haradinaj.

Në mbledhjen e së martës kabinetit qeveritar ka miratuar vendimin për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit të Qeverisë nr. 01/76 të datës 21. 11. 2018, me të cilin përjashtohen nga taksat mallrat me origjinë nga Serbia dhe Bosnja dhe Hercegovina që janë importuar deri më 21. 11. 2018 dhe janë gjetur nën procedurat doganore me regjim të pezulluar (depo doganore, import të përkohshëm, përpunim nën kontroll doganor dhe përpunim i brendshëm) me rastin e lëshimit në qarkullim të lirë. Sipas raportit nga Dogana e Kosovës, prej datës 21. 11. 2018 mallrat me origjinë nga Serbia dhe Bosnja nuk janë lejuar të futen në depo doganore për pezullim të taksave, përveç brendeve.

Ndërsa pas vendimit numër 06/82, datë 28. 12. 2018, kjo ndalesë vlen edhe për brendet ndërkombëtare. Sipas kriterit të licencimit për depo doganore është paraparë që çdo mall në

import me regjim në depo doganore të shkarkohet brenda një viti nga data e importit, përveç rasteve të veçanta. Po ashtu, Qeveria të martën ka miratuar Kodin e Procedurës Penale. Në hartimin e këtij kodi janë marrë parasysh eliminimi i të gjitha mangësive, zbrazëtive dhe vështirësive të evidentuara gjatë zbatimit të kodit aktual. Gjithashtu, kabinetit qeveritar ka miratuar vendimin për organizimin dhe funksionimin e strukturave institucionale për të dhëna të hapura, i cili ka për qëllim ta ngrehë transparencën dhe llogaridhënien e institucioneve publike.

Qeveria e Kosovës ka themeluar Komitetin Ndërmintor për përzgjedhjen e projektit në pajtim me Ligjin për Komplexin Memorial "Adem Jashari" në Prekaz. Komplexi Memorial "Adem Jashari" në Prekaz do të realizohet sipas projektit që do të përzgjidhet pas një shpallje të hapur publike. Projekti duhet ta përmbajë pjesën e varrezave, konservimin e kullave të rezistencës, bunkerin, objektin informativ, amfiteatrin veror dhe objekte të tjera përcjellëse.

## Remi intervistohet në Hagë për të dytën ditë me radhë

**HAGË, 15 JANAR** - Ish-komandanti i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Rrustem Mustafa, po merret në pyetje për të dytën ditë me radhë në Gjykatën Speciale. Mustafa hyri të martën në selinë e kësaj prokurorie në Hagë, i shoqëruar nga avokati i tij, Arianit Koci, pak para orës 10:00 të mëngjesit, por

asnjëri prej tyre nuk folën për mediet. Prokuroria Speciale nuk ka dalë ende me asnjë informacion për ish-pjesëtarët UÇK-së që janë ftuar për t'u marrë në pyetje. Po ashtu, nuk dihet ende se në çfarë cilësie po intervistohet Mustafa, ndonëse vetë ka pohuar më herët

se ai është "dëshmitar i dyshuar". Sot (e mërkurë) në Hagë pritet të intervistohet edhe Sami Lushtaku, një tjetër ish-komandant i UÇK-së, ndërsa të ftuar për intervistim janë edhe të tjerë. Edhe Mustafa, edhe Lushtaku kanë qenë komandantë të rëndësishëm të zonave operative në

Kosovë gjatë luftës në Kosovë, ndërsa pas luftës kanë mbetur aktivë në skenën politike në kuadër të Partisë Demokratike të Kosovës (PDK).

Gjykata Speciale do t'i trajtojë krimet e supozuara që përfshijnë periudhën janar 1998 - dhjetor 2000.



Flet për "Epokën e re", Talat Xhaferi

# Pa shqiptarët Maqedonia nuk



Kryetari i Kuvendit të Maqedonisë Veriore, Talat Xhaferi, ka bërë me dije se falë mbështetjes së shqiptarëve Maqedonia ka arritur në prag të anëtarësimit në NATO. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka deklaruar se pa mbështetjen e deputetëve shqiptarë nuk do të mund të ratifikoheshin ndryshimet e nevojshme kushtetuese të parapara me marrëveshjen e Prespës e cila ia hapi perspektivën euroatlantike Maqedonisë. Kryeparlamentari i Maqedonisë ka vlerësuar se ka vepruar në bazë të kompetencave kushtetuese kur ka nënshkruar Ligjin për përdorimin e gjuhëve. Kreu i Kuvendit të Maqedonisë ka mohuar mundësinë që tani ky shtet të shkojë në zgjedhje të parakohshme. Sipas Xhaferit, Maqedonia nuk e ka luksin të shkojë në zgjedhje në kohën e nisjes së negociatave për integrimet euroatlantike

pushtetit ekzekutiv dhe nuk mund të përzihet në pjesën e pushtetit ligjvënës dhe mos ta përmbushë obligimin vetë. Kështu që, sipas nenin 52, ligjet shpallen në gazetën zyrtare dhe ajo është kompetencë e parlamentit. Nuk kam mundur të lejojë që në pafundësi kreu i shtetit ta pengojë vendosjen në jetë të dy ligjeve për të cilat po flasim", ka deklaruar ai, duke shprehur optimizëm se ligji për gjuhët do të zbatohet në përpikëri. Kreu i Kuvendit të Maqedonisë ka mohuar mundësinë që tani ky shtet të shkojë në zgjedhje të parakohshme. Sipas tij, Maqedonia nuk e ka luksin të shkojë në zgjedhje në kohën e nisjes së negociatave për integrimet euroatlantike.

kryetarit të Kuvendit dhe në kuadër të kompetencave të mia kushtetuese kam nënshkruar dy dekrete të cilat bashkë me tekstet përkatëse i dërgova për publikim në Gazetën Zyrtare. Dekreti i parë ka qenë për shpalljen e Ligjit për përdorimin e gjuhëve, të cilin Kuvendi i Republikës së Maqedonisë e ka nxjerrë në mars të vitit 2018 dhe i njëjti hyn në fuqi në ditën e shpalljes në Gazetën Zyrtare. Dekreti i dytë ka të bëjë me Ligjin për ratifikimin e Marrëveshjes me Greqinë. Në kontekstin e ndryshimeve kushtetuese dhe të gjitha veprimeve në aspektin përgjithshëm që bëhen kemi mbajtur llogari për të mos dëmtuar procesin për integrimet euroatlantike, për faktin se ato janë përcaktim programore të subjektit të cilit i takoj. Për këtë arsye kemi shkuar paralelisht me dy proceset, që ta përcjellim bashkërisht edhe Ligjin për gjuhët dhe Ligjin për ratifikimin e marrëveshjes me Greqinë sepse ditën e hënë u plotësuan të gjitha parakushtet që të dy ligjet të mund të adresohen në Gazetën Zyrtare.

**EPOKA E RE****Muhamet KOCI**

**PRISHTINË, 15 JANAR** - Kryetari i Kuvendit të Maqedonisë Veriore, Talat Xhaferi, ka bërë me dije se pa subjektet politike shqiptare Maqedonia nuk do të mund të arrinte deri këtu. Ai ka deklaruar se pa mbështetjen e shqiptarëve nuk do të mund të ratifikoheshin ndryshimet e nevojshme kushtetuese të parapara me marrëveshjen e Prespës, e cila ia hapi rrugën Maqedonisë drejt integritet në NATO dhe BE. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Xhaferi ka vlerësuar se orientimet programore të

shqiptarëve çdoherë kanë qenë pro integritet të vendit në strukturat euroatlantike. "Gjithsesi pa përcaktimin dhe pa mbështetjen e subjekteve politike shqiptare, deputetëve shqiptarë në parlament, nuk do të mund të arrihej e gjithë kjo. Dy të tretat e votave në parlament nuk mund të bëheshin pa mbështetjen e deputetëve shqiptarë. Mendoj se partitë politike shqiptare dhe deputetët shqiptarë kanë qenë të vetëdijshëm kundrejt përcaktimeve programore të tyre, me të cilat kanë dalë në zgjedhje dhe e kanë kërkuar votën e elektoratit", ka thënë Xhaferi. Ai ka vlerësuar se nuk

ndien asnjë përgjegjësi për nënshkrimin e dy dekreteve të ligjeve të cilat, bashkë me tekstet përkatëse, janë dërguar për publikim në Gazetën Zyrtare. Xhaferi ka treguar se prej fillimit të procedurës për nxjerrjen e Ligjit për përdorimin e gjuhëve ka vepruar në kuadër të veprimeve dhe procedurave të përcaktuara në Kushtetutë. "Konsideroj se është keqpërdorur detyra zyrtare nga ana e presidentit të Republikës me mosnënshkrimin e dekretit për ligjin sepse, sipas nenit 8 të Kushtetutës, është e qartë ndarja e pushteteve në atë ligjvënës, ekzekutiv dhe gjyqësor. Presidenti është pjesë e

**"Epoka e re": Z. Xhaferi, e keni firmosur Ligjin për përdorimin e gjuhëve, duke e dorëzuar për botim në Gazetën Zyrtare. Cila ka qenë ndjesia juaj në atë moment dhe çfarë rëndësie ka ky ligj për shqiptarët atje?**

**Xhaferi:** Të them të drejtën nuk jam prej personave euforik për çështje që janë institucionale dhe procedurale të cilat duhet të kryhen. Në cilësinë e

# do t'i kishte këto të arritura



**"Epoka e re":** Presidenti maqedonas ka reaguar për mënyrën e tillë të procedimit të këtyre ligjeve, duke thënë se këto veprime janë jokushtetuese?

**Xhaferi:** Presidenti i shtetit duhet të mbajë llogari për përgjegjësitë që ka në raport me Kushtetutën për faktin se Kushtetuta në nenin 75 e obligon që pas rivotimit të ligjit, pra pas shfrytëzimit të vetos së tij, ta nënshkruajë dekretin për shpalljen e ligjit. Meqenëse ai e ka refuzuar një gjë të tillë dhe kur veprimi i tij është bërë praktikë nga ai që të mos i respektojë vendimet e parlamentit, atëherë ne kemi vepruar. Sipas përcaktimeve të Kushtetutës, vlerat themelore të sistemit politik dhe të shtetit të Maqedonisë janë ndarja e pushteteve: ligjvënës, ekzekutiv dhe gjyqësor. Prej fillimit të procedurës për nxjerrjen e Ligjit për përdorimin e gjuhëve kam vepruar në kuadër të veprimeve dhe procedurave të përcaktuara në Kushtetutë dhe në Rregulloren për punë të Kuvendit. Përkundrazi, konsideroj se është keqpërdorur detyra zyrtare nga ana e presidentit të Republikës me mosnënshkrimin e dekretit për ligjin. Sipas nenit 8 të Kushtetutës, është e qartë ndarja e pushteteve në atë ligjvënës, ekzekutiv dhe gjyqësor. Presidenti është pjesë e pushtetit ekzekutiv dhe nuk mund të përzihet në pjesën e pushtetit ligjvënës. Kështu që, sipas nenin 52, ligjet shpallen në Gazetën Zyrtare dhe kjo është kompetencë e parlamentit. Nuk kam mundur të lejoj që në pafundësi kreu i shtetit ta pengojë vendosjen në jetë të dy ligjeve për të cilat po flasim. Me arsyetimet e duhura i kam përcjell dy ligjet në Gazetën Zyrtare.

**"Epoka e re":** Tani nuk mund ta ndalë askush fuqizimin e këtyre dy ligjeve?

**Xhaferi:** Absolutisht jo. Në bazë të Kushtetutës, nëse dikush dëshiron të ngrehë vlerësim të kushtetutshmërisë së këtyre dy ligjeve, duhet t'i drejtohen Gjykatës Kushtetuese. Vetëm ky institucion mund të vlerësojë nëse këto ligje janë kushtetuese apo nuk janë kushtetuese. Askush tjetër nuk mund të bëjë vlerësime të tilla.

**"Epoka e re":** Sa pritni që të zbatohet në praktikë ligji për gjuhët?

**Xhaferi:** Mendoj se ligji duhet të zbatohet ashtu siç është i sanksionuar me normat ligjore. Në normat kalimtare ka faza kalimtare ose afate për zbatim në praktikë të pjesëve kryesore. Në kuptimin e saj që nënkupton neni 7, në kontekstin e emërimit të institucioneve qendrore, është paraparë afati prej gjashtë muajve nga hyrja në fuqi e ligjit që të zbatohet ky nen. Pra, që të bëhet ndërrimi i mbishkrimeve, tabelave dhe gjerave të tjera. Po kjo nuk nënkupton se gjërat e tjera që janë të rrjedhës së përditshme të presin. Ato mund të bëhen prej hyrjes në fuqi të ligjit. Prandaj ligji hyn në fuqi prej shpalljes në Gazetën Zyrtare, që i bie prej sot, ditë e martë.

**"Epoka e re":** Kuvendi i Maqedonisë tashmë ka miratuar edhe ndryshimet kushtetuese rreth emrit, të cilat janë paraparë në marrëveshjen e Prespës. Cila është rëndësia e këtij veprimi

të Parlamentit të Maqedonisë?

**Xhaferi:** Parlamenti ka zbatuar kompetencat e veta të paracaktuar në Kushtetutë dhe në Rregulloren e Punës. Mbi këtë bazë ka siguruar shumicën e nevojshme të votave për t'i miratuar ndryshimet e nevojshme kushtetuese. Ne kemi bërë hapin e duhur që t'i plotësojmë obligimet që burojnë nga marrëveshja me Greqinë. Tani mbetet që edhe parlamenti grek ta bëjë ratifikimin e marrëveshjes. Më pas parlamenti grek duhet ta bëjë edhe ratifikimin e protokollit për anëtarësim në NATO dhe me këtë praktikisht hapet rruga e Maqedonisë për anëtarësim në NATO. Në këtë drejtim deri në muajin qershor duhet t'i plotësojmë edhe kushtet e tjera për përcaktimin e datës për fillimin e negociatave për anëtarësim në BE. Me këtë përafrohet i gjithë procesi që të jemi në rrugën e duhur drejt integritetit të plotë të Maqedonisë në BE dhe në NATO.

**"Epoka e re":** Në gjithë këtë proces, cili ka qenë kontributi i subjekteve politike të shqiptarëve që Maqedonia të vijë deri këtu?

**Xhaferi:** Pa përcaktimin dhe pa mbështetjen e subjekteve politike shqiptare, deputetëve shqiptarë në parlament, nuk do të mund të arrihej e gjithë kjo. Dy të tretat e votave në parlament nuk mund të bëheshin pa mbështetjen e deputetëve shqiptarë. Mendoj se partitë politike shqiptare dhe deputetët shqiptarë kanë qenë të vetëdijshëm kundrejt

përcaktimeve programore të tyre me të cilat kanë dalë në zgjedhje dhe e kanë kërkuar votën e elektoratit. Pra, kanë qenë të vetëdijshëm për përcaktimin strategjik të tyre, të shtetit dhe të qytetarëve në përgjithësi, për anëtarësimin e Maqedonisë në NATO dhe në BE. Në këtë kontekst mendoj se partitë politike shqiptare janë sjell në drejtim të duhur dhe në drejtim të interesave strategjike.

**"Epoka e re":** Pas miratimit të këtyre ndryshimeve kushtetuese kemi pasur një reagim të opozitës në Maqedoni, e cila ka kërkuar zgjedhje të reja. Janë të nevojshme zgjedhjet e reja në këtë shtet?

**Xhaferi:** Është e drejtë e çdo subjekti politik që të ketë mendim ndryshe ose të ketë kërkesa të caktuara. Në këtë drejtim është edhe e drejta e opozitës që të kërkojë zgjedhje të parakohshme. Unë si kryetar parlamenti nuk mendoj se Republika e Maqedonisë e ka luksin që në këtë moment të volitshëm drejt integritimeve euroatlantike të rikthehet mbrapa, pra me një proces zgjedhor të parakohshëm. Me këtë veprim do të pezulloheshin kompetencat e të gjitha institucioneve, ndërsa bisedimet për integritime duhet t'i bëjnë institucionet përkatëse. Nëse jemi në fushatë zgjedhore nënkuptohet se nuk ka parlament, nuk ka qeveri dhe atëherë kush do të jenë ata që do të bëjnë bisedime për anëtarësim në NATO dhe BE.

## Më shumë se 200 persona kërkuar ndihmë në Emergjencë

EPOKA  
ERE

Faton DËRMAKU

**PRISHTINË, 15 JANAR** - Dyqind e tridhjetetë (233) persona kanë marrë shërbimet e nevojshme mjekësore gjatë 24 orëve në Klinikën Emergjente të Qendrës Klinike Universitare të Kosovës, 43 prej tyre janë trajtuar në dhomën e reanimimit. Brenda kësaj periudhe kohore kishte 38 raste kirurgjike, 78 raste internistike dhe 61 raste ishin në dhomën ortopedike. Njëzet e një (21) persona kanë kërkuar ndihmë mjekësore, si pasojë e aksidenteve në komunikacion. Për trajtim të mëturshëm, në klinikat e QKUK-së janë pranuar 28 pacientë. Kurse në

Emergjencën e Pediatrikë të Klinikës Pediatrike në QKUK janë trajtuar 79 raste gjatë 24 orëve të fundit. Për trajtim të mëturshëm mjekësor janë pranuar 27 fëmijë. Në bazë të raportit të punës, për këtë periudhë kohore 93 pacientë janë kontrolluar në ambulancat specialistike.

Ndërkaq 28 lindje janë regjistruar gjatë 24 orëve në Klinikën e Gjinekologjisë të Qendrës Klinike Universitare të Kosovës. Tetëmbëdhjetë (18) foshnja i përkasin gjinisë femërore, kurse 10 gjinisë mashkullore. Pesë (5) prej lindjeve janë realizuar me operacion, ndërsa 9 gra janë bërë nëna për herë të parë.



## Bahtiri sot ua dorëzon institucioneve qendrore peticionin për bashkimin e qytetit të Mitrovicës

MITROVICË, 15 JANAR (ER) - Kryetari i Komunës së Mitrovicës Jugore, Agim Bahtiri, sot (e mërkurë) në orën 9:30 do ta dorëzojë peticionin për bashkimin e qytetit të Mitrovicës me 16 594 nënshkrime të qytetarëve, në tri institucionet e Kosovës, te Qeveria, Kuvendi si dhe te presidenti. Sipas një njoftimi për media të kësaj komune, Bahtiri do të kërkojë nga institucionet përkatëse të miratojnë këtë nismë të ndërmarrë nga vetë qytetarët e Mitrovicës.



## KFOR-i italian ofron mbështetje për Komunën e Malishevës

MALISHEVË, 15 JANAR (ER) - Nënkyetari i Komunës së Malishevës, Hajdin Berisha, dhe drejtori Komunal për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, Liridon Hoti, kanë pritur të martën në një takim përfaqësuesit e njësisë së LMT-së të KFOR-it italian, me të cilët kanë biseduar për planifikimet e kësaj njësie për të bashkëpunuar me

komunën në disa fusha me interes të ndërsjellë. Berisha ka falënderuar KFOR-in për këtë bashkëpunim dhe është shprehur i gatshëm për të bashkëpunuar në fushat në të cilat LMT-ja është e gatshme të ofrojë disa nga shërbimet dhe praktikat e saj. Sipas zyrtarëve të LMT-së, ata janë të gatshëm të ofrojnë disa lloje të kurseve të cilat planifikojnë

t'i bëjnë në vijim, duke filluar me një kurs në fushën e gastronomisë, pastaj kurs për dhënie të ndihmës së parë, kryesisht në shkollë, kurs për krijimin e një skuadre për dezinfektim, dezinfektim dhe derratizim, si dhe një kurs për sigurinë në punë. Po ashtu, LMT-ja ka shprehur interesimin edhe për ndihmë në fushën e shëndetësisë.

## Studentë nga ShBA-ja vizitojnë Universitetin 'Ukshin Hoti'

PRIZREN, 15 JANAR (ER) - Universitetin "Ukshin Hoti" në Prizren e kanë vizituar të martën një grup studentësh të profileve të ndryshme nga Universiteti Drake në Iowa të Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Ata janë pritur në takim nga ushtruesi i detyrës së rektorit të këtij universiteti, Ismet Temaj. Me këtë rast, Temaj i ka njoftuar studentët me gjendjen në universitet, të arriturat dhe sfidat me të cilat po ballafaqohet ky institucion. Ndër të tjera, Temaj ka bërë me dije se në UPZ është specifik organizimi i studimeve në disa drejtime, krahas gjuhës shqipe edhe në gjuhën turke dhe boshnjake, në Fakultetin e Edukimit dhe në Fakultetin e Shkencave Kompjuterike. Temaj ka thënë se UPZ-ja ka bashkëpunim me shumë universitete si brenda vendit, në regjion dhe më gjerë, përfshirë edhe ShBA-në.

Ndërsa studentët ishin kureshtarë të dinin më shumë për UPZ-në dhe për gjendjen në arsimin e lartë në përgjithësi në vend. Në fund të vizitës ata janë njoftuar me hapësirat në kompleksin e Universitetit "Ukshin Hoti".



## Mbi 40 mijë dokumente janë shtypur nga E-Kiosku në Prishtinë

PRISHTINË, 15 JANAR (ER) - Komuna e Prishtinës ka bërë me dije se vetëm në vitin 2018 janë shtypur mbi 40 mijë dokumente në E-Kioskun në kryeqytet nga ana e qytetarëve. Kjo komunë ka

theksuar se një investim i tillë ka lehtësuar punën e punëtorëve dhe në të njëjtën kohë ka përshpejtuar shërbimet ndaj qytetarëve. "40 313 dokumente janë shtypur nga E-Kiosku vetëm gjatë vitit

2018. Që i bie, po aq njerëz më pak në sportelet e komunës. Investim i duhur që lehtësoi punën e punëtorëve dhe shpejtoi shërbimin ndaj qytetarëve", ka njoftuar Komuna e Prishtinës.



Është përkujtuar masakra e Reçakut në 20-vjetorin e saj

# Masakra e Reçakut, themel i lirisë dhe pavarësisë së Kosovës



Ndonëse janë bërë dy dekada që kur forcat serbe kanë vrarë 45 civilë shqiptarë në fshatin Reçak të Komunës së Shtimes, kryerësit e këtij krimi ende nuk kanë dalë para drejtësisë. Në 20-vjetorin e kësaj masakre drejtuesit e institucioneve të Kosovës kanë përkujtuar të rënët si dhe kanë kërkuar drejtësi për viktimat. Sipas udhëheqësve institucionalë, masakra e Reçakut është themel i lirisë dhe pavarësisë së shtetit të Kosovës

**EPOKA E RE**

**Shqipe HETEMI**

**PRISHTINË, 15 JANAR** - Në fshatin Reçak të Shtimes 20 vjet më parë forcat policore dhe ushtarake serbe kanë kryer një rënje nga masakrat më të dhimbshme ndaj popullit shqiptar, duke vrarë 45 civilë të pafajshëm. Edhe pas dy dekadave kryerësit e këtij krimi nuk kanë dalë para drejtësisë. Në përkujtim të viktimave të kësaj masakre të martën janë bërë homazhe në Kompleksin Përkujtimor në Reçak si dhe është mbajtur një akademi përkujtimore.

Presidenti Hashim Thaçi ka thënë se 15 janari i vitit 1999, ndonëse ishte një ditë e rëndë për Reçakun dhe Kosovën, ka bërë një kthesë të madhe në ndërkombëtarizimin e luftës së drejtë të popullit shqiptar. Ai ka thënë se martirët dhe dëshmorët e Reçakut janë themeli i lirisë dhe pavarësisë së Kosovës. "Para 20 vjetësh Reçaku hyri në historinë e Kosovës si simbol i sakrificës dhe martirizimit për lirinë që e gëzojmë sot. 15 janari i vitit 1999 ishte një ditë shumë e rëndë për Reçakun dhe tërë

Kosovën, por ishte edhe një kthesë e madhe për ndërkombëtarizimin e luftës së drejtë të popullit tonë. Pas gjenocidit të ushtruar nga forcat serbe në Reçak u zgjua tërë bota demokratike dhe vuri në lëvizje gjithë diplomacinë ndërkombëtare. Për krimet që forcat policore dhe ushtarake serbe i kanë kryer në Kosovë, një ditë do të japin përgjegjësi. Por, sot e përgjithmonë, ne i kujtojmë dhe nderojmë të gjithë martirët, dëshmorët dhe heronjtë e luftës sonë çlirimtare. Martirët dhe dëshmorët e Reçakut janë themeli i lirisë dhe pavarësisë së Kosovës", ka shkruar Thaçi në llogarinë e vet në "Facebook".

Në nderim të viktimave të 15 janarit të vitit 1999 të martën kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli, ka bërë homazhe në Kompleksin Memorial në Reçak. Ai ka thënë se Reçaku është sinonim i çmimit të lirisë, pavarësisë dhe shtetit të Kosovës. "20 vjet më parë ne gjetëm forcë, që dhembjen ta kthejmë në mobilizim, për ta vazhduar deri në fund rrugën e lirisë. Sot ne jemi po aq të përkushtuar ta jetojmë të sotmen, duke punuar për të ardhmen e

sigurt dhe krenare të kombit tonë. Kemi për çfarë të ndihemi krenarë", është shprehur ai, duke shtuar se institucionet kanë për obligim t'i reflektojnë sakrificat e të kaluarës për ta ndërtuar një shtet siç e deshën heronjtë e Reçakut, të Prekazit e të gjithë Kosovës. "Sot mund të mos jemi ende në gjendje për të vënë para drejtësisë ata që bënë masakrën e Reçakut, të Mejës, Rezallës, Studimes, Krushës, Prekazit, Suharekës, e që adresë dhe strehë e kanë Serbinë. Por, sot kur po flasim për dialogun e shumëpërfolur të muajve të fundit, as në Beograd më nuk po flitet për idenë e rikthimit të Serbisë në Kosovë. Në Beograd tani po flitet për formën se si Serbia ta njohë shtetin e Kosovës. Serbia është dëbuar, për të mos u kthyer kurrë më në Kosovë dhe meritat për këtë i keni ju qytetarë të pathyeshëm të Reçakut, i ka Ushtria Çlirimtare e Kosovës, mbarë kombi ynë. Ndërsa, garancë, nga 15 dhjetori i vitit të kaluar, është ushtria e Kosovës", ka deklaruar Veseli.

Ndërkohë kryeministri Ramush Haradinaj ka rikujtuar se dy dekada

më parë, një akt çnjerëzor ka tronditur ndjenjat e botës demokratike dhe ka mobilizuar Perëndimin që me forcë ta ndalte shfarosjen e një populli të tërë. Ai ka thënë se masakra e Reçakut është dëshmia e krimit gjenocidal në Kosovë, e cila shënoi momentin vendimtar të kthesës në luftën dhe përpjekjet tona për liri dhe pavarësi. "Për gjithë popullin e Kosovës, gjithë lirinë, sot është një ditë respekti, ditë nderimi për të rënët në Reçak. Me pietet dhe respektin më të thellë, përjetë do t'i kujtojmë të gjithë martirët, dëshmorët dhe heronjtë, që me fljimin e tyre u bënë gurthemel i lirisë sonë. Lavdi e përjetshme të rënëve të Reçakut dhe të gjithë të rënëve për liri", ka theksuar Haradinaj.

Ai ka folur edhe për taksën që ka vendosur ndaj Serbisë duke thënë se i janë dhënë dy dekada kohë për vetëdijesim. "20 vjet ia kemi dhënë shansin e vetëdijesimit, të përfundojnë disa punë që s'kanë përfunduar dhe pas 20 vjetëve ne jemi detyruar edhe një herë të kthehemi kah vetja. Është e drejtë mbrojtja e vetes dhe mbi këtë të drejtë të popullit është formuar edhe ushtria. Duhet të kthehemi kah vetja, t'i besojmë dhe ta forcojmë atë, sepse nëse vazhdojmë ta forcojmë Kosovën me institucione, qeverisje, me vlera, ju siguroj se miqtë e kanë shumë lehtë të na përkrasin", është shprehur kryeministri Haradinaj. Edhe kryetari i Lidhjes

Demokratike të Kosovës (LDK), Isa Mustafa, ka përkujtuar të rënët e masakrës së Reçakut. Ai ka thënë se 15 janari i vitit 1999 është ndër ditët më të rënda të historisë së Kosovës. "Sot 20 vjet më parë banorët e Reçakut u zgjuan të rrethuar nga forcat e regjimit serb dhe 45 banorë të paarmatosur të këtij fshati u masakruan pamëshirshëm po të njëjtin mëngjes. Të nesërmen, shefi i misionit të OSBE-së, William Walker, pas një vizite nga afër, kishte deklaruar: 'Nga ajo që pashë nuk ngurroj ta përshkruaj ndodhinë si masakër dhe krim kundër njerëzimit!' 15 janari i vitit 1999 është ndër ditët më të rënda, të njërta nga vitet më të rënda, të historisë së Kosovës. Kjo ditë, po ashtu, i paraqiti botës fytyrën e vërtetë të regjimit të Millosheviqit dhe planeve të tij fashiste, duke shënuar kështu kthesën e madhe të qasjes së komunitetit ndërkombëtar ndaj këtij regjimi që rezultoi në bombardimet e NATO-s 78 ditë rresht. U qoftë i lehtë dhe i Kosovës!", ka thënë Mustafa.

Ndërsa lideri i Lëvizjes Vetëvendosje (LV), Albin Kurti, ka theksuar se masakra e Reçakut ka ndërgjegjësuar opinionin publik ndërkombëtar dhe diplomacinë botërore që të ndërhyjë NATO-ja kundër Jugosllavisë së Millosheviqit. Ai ka thënë se ende as drejtësia vendore dhe as ajo ndërkombëtare nuk kanë vepruar për t'i vënë prapa grilave ata kriminelë të cilët goditën në mënyrë mizore popullsinë civile të pambrojtur e të paarmatosur. "Kujtesa jonë është e freskët për masakrën e Reçakut edhe 20 vjet pas saj. Pamjet ishin aq të tmerrshme saqë ne tronditemi prej tyre edhe sot e kësaj dite. Drejtësia është aq e vonuar saqë ajo ende nuk ka filluar. Nuk është gjykuar e dënuar asnjë polic apo ushtarak serb për këtë krim të pashembullt. Sot, dy dekada më vonë, ne përulemi me respekt e me dhimbje, por edhe me krenari, për martirët dhe dëshmorët e kombit në përgjithësi, posaçërisht për ata këtu në Reçak. Familjarët e të vrarëve janë, po ashtu, viktimat dhe çdo ditë që kalon është ditë e padrejtësisë për ta. Dëshmorëve dhe martirëve të kombit si dhe familjeve të tyre ne si qytetarë, si politikanë, si përfaqësues, si aktivistë iu kemi shumë borxh. Lavdi të gjithë dëshmorëve dhe martirëve të kombit shqiptar!", është shprehur Kurti.

Homazhe te Kompleksi Memorial në Reçak ka bërë edhe kryesia e Nismës Socialdemokrate e kryesuar nga kryetari i Këshillit Kombëtar, Jakup Krasniqi. Po ashtu, të rënët në Reçak i kanë nderuar edhe ministri i Mbrojtjes, Rustem Berisha dhe komandanti i FSK-së, gjenerallejtnant Rama.

# Mbahet dëgjimi publik për autostradën e Dukagjinit



**GJAKOVË, 15 JANAR (ER)** - Të martën në qytetin e Gjakovës është mbajtur debati publik për shqyrtimin e variantit më të mirë të autostradës së Dukagjinit (Istog-Pejë-Deçan-Gjakovë-Prizren) me gjatësi 91-95 kilometra. Sa i për-

ket segmentit të Gjakovës do të ketë tri hyrje: në Skivjan, Qerim dhe Rezinë. Në këtë debat morën pjesë kryetari i Komunës së Gjakovës, Ardian Gjini dhe Ministri i infrastrukturës, Pal Lekaj.

Kryetari Gjini ka thënë se ky projekt është ndër projektet më të mëdha për Komunën e Gjakovës dhe se është tejet i lumtur për realizimin e këtij projekti, gjithashtu shprehu falënderime ndaj kryeministrit Ramush

Haradinaj dhe ministrit Lekaj. Ndërkaq ministri Pal Lekaj ka thënë se projekti i Autostradës së Dukagjinit është projekti më gjigand dhe më atraktiv që po realizohet nga Qeveria e udhëhequr nga Haradinaj. Ai i siguroi qyte-

tarët se projekti i autostradës së Dukagjinit do të realizohet sipas kriterëve dhe standardeve të Evropës. Pas prezantimit të projektit nga kompania projektuese, qytetarët dhanë komentet e tyre lidhur me këtë projekt madhor.

# Banka Botërore jep mbi 60 milionë euro për projektet në bujqësi



**PRISHTINË, 15 JANAR (ER)** - Banka Botërore do ta vazhdojë mbështetjen e projekteve për bujqësi dhe zhvillim në Kosovë me një fond mbi 60 milionë euro. Kjo mbështetje është bërë me dije gjatë takimit që ministri i Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Nenad Rikalo, pati me përfaqësuesit e Grupit të

Bankës Botërore (BB), me të cilët ka diskutuar për Projektin e ardhshëm për Bujqësi dhe Zhvillim Rural. Gjatë këtij takimi, ministri Rikalo dhe zyrtarët e BB-së diskutuan për fazat e përgatitjes së projektit të ri, të cilat tashmë kanë filluar dhe me këtë rast ata kanë treguar se mbështetja në kuadër të këtij

projekti do të bazohet në tri shtylla kryesore: Ujitjen e tokës bujqësore, ndotjen e tokës bujqësore, si dhe investimet në bujqësinë mjedisore. Po ashtu, u theksua se ky projekt do të realizohet në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor. Ministri Rikalo falënderoi

Bankën Botërore për mbështetjen që ka dhënë në vazhdimësi për sektorin e bujqësisë, duke vlerësuar se kjo mbështetje ka sjellë rezultate mjaft konkrete dhe të rëndësishme. Me këtë rast, ai i ka njoftuar ata për Programin për Bujqësi dhe Zhvillim Rural 2019 si dhe për projektet e tjera zhvillimore të ministrisë për

zhvillimin e sektorit të bujqësisë në vend. Ndërsa zyrtarët e Bankës Botërore shprehën gatishmërinë për ta vazhduar mbështetjen për sektorin e bujqësisë, duke i vlerësuar të arriturat në këtë sektor që po ofron një nga mundësitë më të mira për punësim dhe zhvillim ekonomik.



# Kosova hapi zyrën doganore në Portin e Durrësit



Dogana e Kosovës ka hapur të martën zyrën doganore në Portin e Durrësit. Kjo zyre është cilësuar nga përfaqësuesit e Kosovës dhe të Shqipërisë si hap që do t'i rrisë shkëmbimet tregtare ndërmjet dy shteteve. Shkëmbimet tregtare përmes Portit të Durrësit pritet ta shkurtojnë koston e shpenzimeve të transportit, kohën si dhe zbutjen e procedurave burokratike tregtare. Zëvendëskryeministri Fatmir Limaj ka thënë se ky është projekti më i rëndësishëm konkret në mes të Kosovës dhe Shqipërisë

**EPOKA E RE** **Albulena S. MAVRAJ**

**DURRËS, 15 JANAR** - Zëvendëskryeministri i Kosovës, Fatmir Limaj, i shoqëruar edhe nga ministri i Financave, Bedri Hamza dhe drejtori i Përgjithshëm i Doganave të Kosovës, Bahri Berisha, të martën mori pjesë në hapjen e Zyrës së Doganës së Kosovës në Portin e Durrësit. Me këtë rast, zëvendëskryeministri Limaj ka thënë se sot

është një moment i rëndësishëm me qëllim të integritimit dhe të bashkëpunimit në mes të Shqipërisë dhe Kosovës, duke vlerësuar se ky projekt është i dyti më i rëndësishëm që nga shpallja e pavarësisë së Kosovës që po implementohet sot. "Pas një pune të përbashkët, një projekti të përbashkët madhor të ndërtimit të Autostradës Tiranë - Prishtinë, sot në këtë ditë është projekti më i rëndësishëm konkret në mes të Kosovës dhe Shqipërisë,

integrimi i doganave si vizion yni i përbashkët drejt unionit doganor në mes të Kosovës dhe Shqipërisë", ka thënë zëvendëskryeministri Limaj. Më tej, zëvendëskryeministri Limaj në cilësinë e Koordinatorit Kombëtar për mbikëqyrjen e zbatimit të marrëveshjeve të të dy qeverive ka pohuar se nga katër vendimet e marra në mbledhjen e përbashkët të Qeverive të mbajtur në Pejë tanimë po implementohet marrëveshja e dytë, e

para është integrimi i kufijve në fillim të këtij viti dhe e cila pritet të përfundojë në mars dhe sot Dogana e Kosovës po themelohet në Portin e Durrësit.

Ministri i Financave, Bedri Hamza, ka thënë se ndihet tepër i nderuar që në cilësinë e ministrit të Financave të marrë pjesë në hapjen e pikës doganore, të Doganave të Republikës së Kosovës në portin e Durrësit. Më tej, ministri Hamza falënderoi për përkrahjen e vazhdueshme dhe angazhimin e tyre për realizimin e këtij qëllimi, kryeministrin e Republikës së Shqipërisë, Edi Rama dhe zëvendëskryeministrin e Republikës së Kosovës, Fatmir Limaj.

Ministri Hamza ka thënë se qëllimi dhe prioriteti i lartë i

Qeverisë së Kosovës është rritja ekonomike dhe bartës i këtij zhvillimi do të jetë sektori privat.

Kryeministri i Republikës së Shqipërisë, Edi Rama, ka thënë se ndihet mirë që sot po mbledhen në një stacion tjetër të rrugëtimit të projektuar në mbledhjen e dy qeverive për ta hapur Zyrën Doganore të Kosovës në Durrës dhe për ta kthyer kështu portin e Durrësit jo vetëm në një Doganë të Shqipërisë, por edhe në Doganë të Kosovës, duke shtuar se ky është hapi i parë i rëndësishëm drejt bashkimit të plotë doganor në mes të Shqipërisë dhe Kosovës, shkurtimi i burokracive, i orëve të pritjes së kontrolleve, i kostove të pallogaritshme për bizneset janë efekt i drejtpërdrejtë i hapjes së kësaj zyre doganore.

## Kompania "Meka Halal Food" ua jep pagën e 14-t punëtorëve

**PRISHTINË, 15 JANAR (ER)** - Kompania vendore "Meka Halal Food" ka njoftuar se punëtorëve të vet ua ka dhënë të martën pagën e 14-t. "Ashtu siç ishin planifikimet, ka dashur

i Madhi Zot që të bëhet edhe realizimi. Sot është një ditë shumë e madhe për ne, njëkohësisht kënaqësi e veçantë të bëhet ekzekutimi i pagës së 14-t. Gjithashtu, sot morëm

vendim që në të gjithë sektorët e kompanisë sonë paga minimale nga 1 shkurti i vitit 2019 të jetë 300 euro me të gjithë kontributet e paguara nga kompania. Një falënderim të veçantë

për konsumatorët dhe bashkëpunëtorët tanë", është bërë me dije në njoftimin e kompanisë vendore "Meka Halal Food" në faqen e saj në "Facebook".



# HIPOKRIZIA NDËRKOMBËTARE DHE GJENOCIDI NË KOSOVË



**Bardhyl MAHMUTI**

Në 20-vjetorin e aktit gjenocidar në Reçak, nënkoloneli serb Goran Radosavljeviq-Guri dhe kriminelët e tjerë që kryen gjenocidin kundër shqiptarëve jetojnë të lirë në Serbi. Ndërsa në Hagë, prokurorë ndërkombëtarë, të bazuar në dosjet e sajara prej Shërbimit Sekret të Serbisë, marrin në pyetje gjeneralë të UÇK-së. Kjo është hipokrizia ndërkombëtare ndaj krimit të gjenocidit.

Po sjell për lexuesin pjesë nga dy artikujt e gazetarit Pierre Hazan, i cili në janar të vitit 1999 ishte i dërguari special në Kosovë i gazetës franceze "Libération". Në artikullin e titulluar "Masakra e Reçakut: rrëfimi i një dëshmitari çelës....", Pierre

Hazani sjell rrëfimin e dëshmitarit: "Rreth orës 15:45, një çerek ore pas përfundimit të të shtënave, forcat serbe u larguan nga fshati (...) Ne vendosëm të hynim në Reçak. Një duzinë civilësh ishin aty në një gjendje tronditëse. Një nga ta na zgjati diçka. Një nga njerëzit e mi e mori.

Papritmas konstatuam se ishte pjesë kafke. Përkthyesi ynë na shpjegoi se ky njeri sapo kishte gjetur kufomën e vëllait të vet, me kokë të copëtuar. Ne pamë një trup. Plumbi i kishte krisur mbi kokë dhe tërë kafa ishte copëtuar. Fshatarët na thanë se nja njëzet burra ishin arrestuar (...) Ora ishte rreth 17:30. Bënte terr i zi. I mora pesë të plagosur. Të gjithë civilë. Këtë të premte, për herë të parë dhe të vetme, një grua na tha se burrat ishin dërguar për ekzekutim. Ajo ishte në gjendje tejet të shqetësuar. Vajza e saj ishte e plagosur. Jemi afruar rreth 400 ose 500 metra afër përroit, por nuk pamë gjë. Në orën 18:00 u larguam nga Reçaku..." "Të shtunën në orën 8:45" - vazhdon tregimin

vëzhguesi i OSBE-së, që gazetari e paraqet vetëm me emrin "Mike" - "ne u kthyem përsëri në Reçak. Ushtarët e UÇK-së ishin aty. Ata i zbuluan të vdekurit në të njëjtën kohë me ne (...). Disa media pretendojnë se ata kanë organizuar një inskenim për ta bërë të besueshme masakrën. Duhet të kishin qenë gjeni të inskenimit, të pajisur me një talent të jashtëzakonshëm për aktrim (...).

I morëm gëzhojat si prova. Ndoshta nja dy duzina gëzhoja dhe karikatorë. Ushtarët e UÇK-së i morën nëntë shokët e tyre. Kufoma pa koka. I pashë nja njëzet kufoma në përrua, të ekzekutuara me nga një plumb në kokë. Mandej kufoma të tjera përreth. Këta, sipas asaj që shihet, kanë tentuar të iknin. Pastaj zbrita në fshat, aty ku viktimat ishin vrarë me nga një plumb në kokë ose duke u përpjekur të iknin. Pashë trupin e një djaloshi 12-vjeçar, i vrarë me një plumb pas qafe, pranë kufomës së babait të vet. Pashë kufomën e një burri pa kokë të cilën e gjeti vëllai i tij. I kishin mbetur flokët

e hequra me lëkurën e kafkës. A janë gjymtuar këta trupa apo kafshët ua kanë ngrënë mishin? Nuk e di! Vëllai i vuri ndërmjet shpatullave atë që kishte mbetur nga koka..."

Në artikullin "Ishim të sigurt se të gjithë do të vdesim", Pierre Hazani filloi dëshminë e fshatarëve të Reçakut me thëniet e një fëmije të vrarë në këtë aksion. "Kujdes mami, ata do të vrasin!", ishin fjalët e fundit të Halim Beqirit, 12-vjeçar. Një plumb e goditi pas qafe. Kishte gjak në gojë. Isha dy metra larg. Serbët shtinin nga të gjitha anët. Nuk mund të afrohesha. 'Ata e vranë edhe burrin tim. Ai ishte pranë djalit tonë'", rrëfente nëna e tij, Eminja.

"Burrat u ndanë në disa grupe. Nja 20 veta u dërguan mbi fshat. Na thanë se do të na çonin në stacionin policor. Por dëgjoheshin krisma nga të katër anët", tha Rama, një burrë rreth dyzet vjeç. "Pjesa tjetër e grupit u dërguan në përrua. Policët serbë i prisnin që t'i vrisnin".

"Të shtunën, trupat e këtyre

njëzet burrave ishin ende njëri mbi tjetrin, në pozicionin që ishin vrarë. Ishin ekzekutuar nga afër. Një vdekje e përgatitur dhe e ekzekutuar me gjakftohtësi. Në orën 17:00 serbët u tërhoqën. Të mbijetuarit filluan të lëvizin. Një nga shtëpitë e para të fshatit, afër xhamisë, ishte ajo e Banush Azemit, 62-vjeçar. Kufoma e tij, pa kokë, ishte pranë shtëpisë së tij. Vëllai i tij, Bedriu, 55-vjeçar, kërkonte kokën. Fshatarët e gjetën më vonë. Në fshat ishte edhe një kufomë e një burri të gjymtuar. Një adoleshent sapo kishte gjetur kufomat e tre vëllezërve të tij..." "E shtunë pasdite", vazhdon Pierre Hazani. "Ora ishte gati 15:00 kur erdhi gjenerali Walker, shefi i Misionit të OSBE-së. Të mbijetuarit nga kjo ngjarje e dërguan Walker-in te përroi ku ishin të shtrira mbi njëzet viktimat". "Janë vrarë me nga një plumb në kokë ose pas qafe", deklaroi pa asnjë dyshim William Walkeri...

**(Më gjerësisht këtë shkrim mund ta lexoni në kapitullin e tretë në librin "Mashtrimi i madh")**



## FLETË E SHKËPUTUR NGA DITARI

**Sabri KIÇMARI**

Pas manifestimit përkujtimor nisem për Ulm. Do të marr pjesë në një manifestim me bashkatdhetarë. Rrugës për në Ulm njoftohem për masakrën e Reçakut. Thërras në Zonën Operative të Llapit dhe më njoftojnë se informata është e saktë. Janë vrarë dhjetëra civilë. E marrë në telefon Ministrinë e Jashtme të Gjermanisë. Bisedoi me zyrtarin e kësaj ministrie, z. Heindel. E pret me keqardhje informatën dhe më

thotë se menjëherë do ta njoftojë ministrin Fischer. Pastaj marrë në telefon kabinetin e ministrit të Jashtëm të Holandës dhe e informoj për masakrën që ka ndodhur në fshatin Reçak. Zyrtarja e Ministrisë së Jashtme shpreh hapur në telefon zemërimin ndaj politikës kriminale të Beogradit. Më thotë se ministri Von Aartsen është në një takim dhe porsa të lirohet nga takimi do ta njoftojë për krimin. Pastaj thërras në Ministrinë e Jashtme të Austrisë. E marrë në telefon z. Jandl. Kur i jap informatën për krimin në Reçak,

më thotë:

- Sërish kanë filluar me krime?  
- Ata nuk dinë të ndalur! Janë vrarë civilë të pambrojtur, në mesin e tyre fëmijë dhe pleq.  
- A janë të njoftuar vëzhguesit e OSBE-së? - më pyet.  
- Po, posa mora vesh se janë nisur për në vendin e ngjarjes!  
Më pas vendos të lëshoj një informatë të shkurtër në lidhje me krimin e ndodhur në Reçak për të gjithë gazetarët, adresat e të cilëve i kam të incizuara në laptop. Ndalem në një vendparkim dhe e formuloj shpejt e shpejt tekstin,

duke u bërë lutje redaksive t'i dërgojnë korrespondentët e tyre në Reçak. Informatën e përcjell përmes e-mailit, duke u futur në internet përmes telefonit celular me rreze infra të kuqe. Miku im, Agim Rashani, ma pati rregulluar këtë mënyrë komunikimi për raste të jashtëzakonshme, kur nuk pret koha për përcjelljen e informatës. I gëzohem shumë faktit se arrij ta dërgoj njoftimin.

Pas pak minutash fillojnë thirrjet e gazetarëve. Ata duan ta vërtetojnë saktësinë e informatës. Disa prej tyre më premtojnë se do t'i dërgo-

jnë korrespondentët e tyre në Reçak, kurse të tjerët kërkojnë informata shtesë.

Në mbrëmje arrij në Ulm. Takimi me bashkatdhetarët është jo i lehtë. Shumë prej tyre i përcjellin lajmet në ankh. Fytyrat e tyre flasin për vuajtje të rënda shpirtërore. Secili ka anëtar të familjes në Kosovë. Secili i dëgjon lajmet me drojë se do ta dëgjojë emrin e ndonjërit nga anëtarët e familjes së tyre, që është masakruar a vrarë nga forcat policore serbe. Përpiqem t'u jap shpresë dhe forcë.

Stuttgart - Ulm, 16 janar 1999

# Kushtetuta, autoriteti dhe përvoja, tri fuqitë e presidentit Meta



**Prof. Lisen BASHKURTI**

Prej më shumë se një viti z. Ilir Meta ushtron detyrën e presidentit të Republikës së Shqipërisë. Është një detyrë e vështirë në një moment shumë delikat. Pas reformës kushtetuese të vitit 2016 vendi përballet me një tranzicion konstitucional në sistemin e reformës në drejtësi. Disa institucione kushtetuese janë suprimuar, të tjerë të rinj janë krijuar ose janë në proces krijimi e sipër.

Mungesa e Gjykatës Kushtetuese për shkaqe të njohura e kanë vënë shpesh presidentin në pozicione të vështira për mjaft aspekte të interpretimeve kushtetuese. Mbi të gjitha, tradita e dobët e tranzicionit shqiptar e karakterizuar nga mungesat e bashkëpunimit ndërinstitucional dhe përplasjet institucionale, duke anashkaluar frymën dhe gërmat e Kushtetutës, në tërësi kanë krijuar një mjedis problematik edhe për institucionin e presidentit të Republikës.

Pavarësisht prej këtyre faktorëve mjedisorë të brendshëm problematikë mund të thuhet se institucioni i presidentit të Republikës, nën drejtimin e z. Meta, ka funksionuar në mënyrë kushtetuese, ligjore, bashkëpunuese dhe transparente. Tendencat konjunkturale, prirjet për ta anësuar, forcat goditëse dhe tërheqëse, nuk kanë mundur t'i 'tundojnë' mendimet, qëndrimet dhe veprimet e presidentit Meta nga pozitat e tij institucionale.

Këtë pozicion institucional presidenti Meta e ka përm-bushur jo në mënyrë të mbyllur dhe pasive, siç kemi vërejtur te disa paraardhës në postin e tij presidencial gjatë tranzicionit, por në mënyrë shumë të hapur dhe mjaft aktive. Presidenti Meta ka hapur dyert për të gjithë aktorët shtetërorë dhe joshtetërorë, për dimensionet e brendshme dhe ndërkombëtare, për fushat politike, ekonomike, sociale, kulturore, shkencore, sportive e humanitare. Nga ana tjetër, presidenti Meta është treguar prej aktiv në politikën e jashtme shqiptare, rajonale dhe ndërkombëtare. Aq sa mund të

thuhet se ka qenë aktori kryesor në iniciativat e veprimtaritë e tij ndërkombëtare në Ballkan, Evropë, ShBA dhe në mbarë diasporën shqiptare thuajse kudo në botë. Kjo performancë po e bën presidentin Meta profilin më të spikatur presidencial gjatë tërë periudhës së tranzicionit shqiptar. Këtë tipar individual, si rrallëherë, po e vlerësojnë thuajse te faktorët politikë dhe shoqërorë në vend. Ku qëndron ky sukses presidencial i z. Ilir Meta?

## 1. Pushteti kushtetues

Themeli i pushtetit të presidentit qëndron në bazat kushtetuese të funksionit të tij. Akti unik publik, Kushtetuta e vendos në krye të shtetit dhe përfaqësues të unitetit të popullit. Me përjashtim të limitimit të pushteteve në sistemin e drejtësisë, që u bë pas amendamenteve të Kushtetutës në korrik 2016, kompetencat e tjera të presidentit janë qartësisht të parashikuara në aktin unik publik, sikundër edhe në ligje të veçanta.

Pushteti kushtetues dhe ligjor, i respektuar rigorozisht, në mënyrë të vazhdueshme, të përgjegjshme dhe profesionale, i ka dhënë pushtetin kryesor presidentit Meta. Në mendimet, qëndrimet dhe veprimet e tij, z. Meta ka ruajtur frymën kushtetuese dhe gërmat e saj, kompetencat dhe detyrimet ligjore. Meta as nuk është ngutur dhe as nuk është vonuar në mendimet, qëndrimet dhe veprimet e tij. Meta as nuk ka limituar dhe as nuk ka tejkaluar kompetencat kushtetuese dhe detyrimet ligjore. Meta nuk ka qenë as i mbyllur, as konspirativ dhe as përjashtues. Meta ka qenë i hapur, transparent dhe gjithëpërfshirës në vendimarrjet e tij.

Mosfunksionimi i Gjykatës Kushtetuese ka krijuar një vështirësi pa precedent për presidentin Meta. Por, kjo mangësi serioze institucionale e vendit ka rritur dy dimensionet e pushtetit të presidentit: përgjegjësitë dhe profesionalitetin. Përgjegjësitë vërehen në rritjen e përpjekjeve serioze të presidentit për të ruajtur dhe forcuar bashkëpunimin ndërinstitucional. Në kushtet kur institucioni i presidentit nuk mund ta zëvendësojë Gjykatën Kushtetuese, forcimi i bashkëpunimit ndërinstitucional është mënyra më e mirë dhe e vetme për të shmangur çdo lloj arbitrariteti të mundshëm antikushtetues. Profesionaliteti vërehet në

ngritjen e cilësisë së argumentimit dhe të interpretimit të konstitueshmërisë dhe të ligjshmërisë të të gjitha veprimeve dhe qëndrimeve të presidentit lidhur me ushtrimin e kompetencave presidenciale.

Rastet e kredencialeve të ekipit negociator për bisedimet me Greqinë, rasti i vonësës së dekretimit të ministrit të Brendshëm, Lleshaj, rasti i mosdekretimit të ministrit të Punëve Evropiane dhe të Jashtme, Cakaj etj., janë shoqëruar nga presidenti Meta me argumentim kushtetues dhe ligjor, ndërinstitucional, publik dhe transparent.

Gjatë tranzicionit nuk keni ndeshur bashkëpunim më të mirë ndërinstitucional nën autoritetin e presidentit të Republikës sesa presidenti Meta pavarësisht prej vështirësive të tranzicionit. Gjithashtu, gjatë tranzicionit nuk kemi parë një përpjekje kaq serioze si të presidentit Meta për argumentim të mirë, të plotë, formal dhe publik mbi konstitueshmërinë dhe ligjshmërinë e çdo qëndrimi, vendimi e veprimi të tij. Çdo veprim e mosveprim, çdo dako-rdësim dhe kundërshtim, nga presidenti Meta është shoqëruar me argumentim të përgjegjshëm dhe mjaft profesional. Ky fakt e ka bërë presidentin Meta dhe presidentin si institucion më të fuqishëm dhe autoritar, më të besueshëm e me pritshmëri të larta, njëkohësisht aspak imponues dhe autoritarist.

## 2. Pushteti i personalitetit

Kushtetuta dhe ligjet i japin presidentit pushtet konstitui, ligjor dhe institucional. Por ushtrimi i këtij pushteti është kushtimisht i varur nga personaliteti individual i vetë personit që është në postin e presidentit. Edhe në demokracitë më të konsoliduara, edhe në republikat presidenciale apo gjysmëpresidenciale pushteti i presidentit ka qenë dhe është ngushtësisht i lidhur me personalitetin e individit që e ushtron këtë pushtet.

Individualiteti i Ilir Metës është karakterizuar gjatë tërë kohës dhe në të gjitha pozicionet që ka ushtruar për fuqi të brendshme, për iniciativat të forta, për vendim-marrje të guximshme, për ballafaqime publike, për operacionalitet dinamik, për mbajtje fjale edhe me sakrificat individuale dhe institucionale. Meta i ri, Meta i FRESH-së, Meta i politikës LSI-së, i ekzekutivit, i parlamentit ka një tipar individual - personalitetin e fortë, modest, etik dhe imponues. Kjo është

fuqi personale.

Por tranzicionet po na dëshmojnë se fuqia personale mund të përdoret, shpërdoret dhe abuzohet nga individët në pushtet. Kur fuqia individuale shpërdorohet dhe abuzohet nga pushtetmbajtësit ajo të shpie në autoritarizëm, në mungesë etike, në shpërfillje dhe arrogancë, në qëndrime dhe veprime antikushtetuese dhe antiligjore, në kundërshtim me interesat kombëtare dhe publike, sikundër edhe në qëndrime dhe veprime me rrezikshmëri rajonale dhe ndërkombëtare.

Në rastin e z. Meta, fuqia personale ushtrohet brenda kuadrit kushtetues, ligjor dhe institucional, ushtrohet në përputhje me interesin kombëtar dhe publik dhe në dobi rajonale e ndërkombëtare. Prandaj në këtë rast pushteti individual i z. Meta ose i thënë ndryshe autoriteti personal i tij ndihmon në ushtrimin e pushtetit kushtetues e ligjor, kombëtar dhe publik, rajonal e ndërkombëtar.

## 3. Pushteti i përvojës

Përvoja është një tjetër atribut që i jep individit dhe pozicionit të caktuar të tij pushtet. Rëndësia e përvojës është kudo e çmuar në botën perëndimore të zhvilluar. Në ShBA kudo shkruhet si preferencë e standardizuar për poste publike dhe private: "education or experience only", pra "arsim ose përvojë". Rëndësia e përvojës është veçanërisht e çmuar në politikë.

Edhe vetë historia politike e lidershit në botë dëshmon se liderët të mëdhenj kanë spikatur jo gjithaq nga arsimimi sesa nga përvoja e madhe. Çurçilli, Stalini, Tito, Miterani, Trumani e shumë liderë të tjerë të shekullit të kaluar që kanë lënë gjurmë në histori kanë pasur kryesisht pushtetin e përvojës së tyre.

Në Shqipërinë e tranzicionit shqiptar, z. Ilir Meta, është ndër politikanët me më shumë përvojë. Ai përjetoi një përvojë të gjatë jete parlamentare qysh në moshë fare të re. Ai drejtoi funksionet më të larta ekzekutive, ministër, zëvendëskryeministër, kryeministër për një periudhë të konsiderueshme. Meta themeloi dhe krijoi vetë një parti nga e para, duke e ngritur në nivelin e forcës së tretë politike në vend, në rrethana elektorale shumë të vështira. Në jetën e Kuvendit Meta u shqua si një prej drejtuesve më të suksesshëm, që mbajti gjallë jetën, dialogun, debatin dhe që realizoi konsensusin më të madh në vend për

amendamentet kushtetuese lidhur me reformën në drejtësi.

Këto funksione politike, parlamentare, institucionale kanë qenë shkolla të vërteta për Ilir Metën. Këto shkolla përvoja qëndrojnë në bekgarandin e mendimeve, qëndrimeve dhe vendimeve të tij edhe gjatë ushtrimit të funksionit të presidentit të Republikës. Përvoja është busull orientuese. Përvoja është mësim për të mos gabuar. Përvoja është model për ta garantuar suksesin. Përvoja është dije empirike. Dhe si çdo dije përvoja është pushtet i organizuar. Në tërësi përvoja është dije, vetorganizim, vetësiguri, qartësi, vizion e për rrjedhojë është pushtet i natyrshtëm.

Ka kaluar më se një vit që z. Ilir Meta ushtron detyrën e presidentit të Republikës së Shqipërisë. Një detyrë e vështirë në një moment shumë të komplikuar. Mbas reformës kushtetuese të vitit 2016 disa institucione kushtetuese janë suprimuar, të tjerë të rinj janë krijuar ose janë në proces krijimi e sipër.

Mungesa e Gjykatës Kushtetuese e ka vënë shpesh presidentin në pozicione delikate lidhur me aspekte të interpretimeve kushtetuese, e sidomos tradita e dobët e mungesës së bashkëpunimit ndërinstitucional, e polarizimit politik dhe e përplasjeve institucionale kanë krijuar një mjedis problematik edhe për institucionin e presidentit të Republikës.

Por, pavarësisht prej këtyre faktorëve mjedisorë të brendshëm problematikë, mund të thuhet se institucioni i presidentit të Republikës, nën drejtimin e z. Meta, siç po tregojnë edhe krizat e fundit në vend, po funksionon në mënyrë kushtetuese, ligjore, bashkëpunuese dhe transparente. Dukuritë konjunkturale, prirjet për ta atakuar politikisht, forcat goditëse apo tërheqëse nuk kanë mundur t'i lëkundin mendimet, qëndrimet dhe veprimet e Presidentit Meta nga pozitat e tij kushtetuese dhe institucionale.

Pushteti i presidentit Meta bazohet në tri kolona të fuqishme: te kushtetuta e ligji dhe vullneti tij për t'i respektuar ato me çdo çmim; tek autoriteti personal i bazuar në përgjegjshmëri, transparencë, llogaridhënie dhe gjithëpërfshirje; si dhe në përvojën e tij të gjatë në institucione politike, në institucione ekzekutive dhe parlamentare. Ja përse presidenti Meta është referencë kushtetutshme, është bazë uniteti popullor dhe pikë stabiliteti politik dhe ndërinstitucional në vend.

# Skënderbeu në version më ndryshe

- Heroin kombëtar te ne gjithmonë e inskenojnë dhe e luajnë shabllon

## Ilir MUHARREMI

Aktori duhet të ballafaqohet me shqetësimin e brendshëm, pavarësisht cilin personazh tenton ta krijojë. Ndodh që kapakët e syve, buzët, lëvizjet e duarve dhe në tërësi lëvizjet skenike të mos i kujtohen në tërësi, atëherë ai ka vepruar sipas subkoshiençës. Shpesh kjo na çon në rrugë të gabuar ose rrugë të drejtë. Unë atë natë pashë aktorin Bujar Ahmeti të tërhequr nga personazhi i Skënderbeut, me një përkrenare jo shumë të detajuar, qëndrim të drejtë, si statujë, herë i shtangur e herë i liruar nga zinxhirët e personazhit, kjo e qëllimshme, sepse kështu kërkohet nga roli. Zëri i tij ishte dyzërësh, harmonik, në të cilin ngujohet trishtimi dhe drama njerëzore, dhe dukej shumë njerëzor i minimizuar Skënderbeu, kjo të paktën kërkohet nga aktori e jo nga regjisori i teatrit brenda teatrit. Roli i tij shfaqej plot dhimbje, mallëngjim vramendës.

Dhe, shikuesi menjëherë e merr atë çfarë ndërton regjisori Fadil Hysaj, brendshëm nëpër konceptin e tij, dhe kjo ndonjë për një shikues, i cili e njeh aktrimin ka përvojë me aktorët, si në jetën skenike ashtu edhe në jetën reale. Saora kuptohet psikologjia e personazhit. A ishte aktori i tërhequr nga personazhi, a ndjente dashuri ndaj tij? Mendoj se po. Ai jetonte edhe jashtë vullnetit të tij jetën e rolit dhe nuk i kuptonte mirë ndjenjat e tij, disi çdo gjë i vinte vetvetiu. Theksat e vënë gjatë dialogëve, sidomos kur kishte monologë, duke mos iu referuar saktë lëndës letrare (dramaturgjisë), ai tentonte ta zbuste Skënderbeun, ndërsa në anën tjetër kërkohet ta patetizonte. Këtu mendoj që regjia e kishte tejkalluar tekstin, si plotësim dhe aktualitet, ishte një aureolë dhe i jepte dritë dramaturgjisë.

### Aktorët donin ta vrisnin njëri-tjetrin për rolet kryesore

Skënderbeun në shfaqjen "Skënderbeu, dashuria dhe liria" e shoh të dashuruar pas Arianisë (Donikës) e jo atdheut. Ndjenjat e tij për të i shoh më shumë në fjalë sesa shpirt, ndoshta duhej më shumë ta harronte atdheun dhe i bindur jam se e kishte këtë informatë aktori. Në këtë rast aktori duhet t'i besonte artit të të paraqiturit, ngaqë baza e drejtimit artistik është shumë afër shpirtit të tij dhe ndjenjat e tij artistike këtë e kërkojnë, e ai duhej t'i përulëj. Nëse në skenë dashurojmë, dashurojmë me zë. Dashuria dëgjohet e ngre zërin, atëherë heshtja jonë e audiencës bëhet

spektakolare. Aktori nuk duhet të përkryhet veç në dukje, por zemra e tij duhet të ushtrohet, të shprehet, të shpjegohet përmes gjeve, të cilat zëri dhe trupi i mishërojnë. E kuptojnë ligjin e teatrit se gjithçka kërkohet të zmadhohet, dhe këtë e kërkon regjisori brenda shfaqjes. Regjisori Hysaj si koncept ka tentimin e shfaqjes së Skënderbeut, sidomos në këtë kohë dhe aty hasim në shumë probleme, të cilat i rishfaq aktori Shpëtim Selmani në rolin e regjisorit, i cili zhytet në labirint të shfaqjes.

Ai vazhdimisht ndërhyr, kërkon që aktorët të hiperbolizojnë, të patetizojnë, të zhyten në konceptin e tij, dhe ai vuan nga depressioni dhe ereksioni. Nuk i zihet vendi vend. Sa ulet në pjesën e majtë, e sa në të djathtë. E herë në publik. Ai kërkon nga aktorët t'u shpjegojë se nuk bëhet teatror kushdo. Përmes tij, regjisori Hysaj mëton të tregojë se regjisorët i zëvendësojnë rolet me aktorët e tjerë, ata i gjuhen në qafë me qëllim për t'i caktuar vetë skenat. Ai si regjisor ka mjaft pasiguri dhe kjo vërehet shumë nga aktorët të cilët heraherës ia hedhin kostumin e personazhit. Sipas aktorëve nuk është faji te ta, por te regjisori, sepse gjuha e tij për ta njohur personazhin është e mangët. Sipas dialogëve na del se aktorët kurrë nuk mund të bëhen si personazhet dhe duhet të krijohet një konvencion për ta. Subjekti i shfaqjes ndërtohet mbi atë llomin e grabitjes tinëzare të roleve, aktorët donin ta vrisnin njëri-tjetrin për rolet kryesore dhe hilet që i bënin me qëllim për t'i fituar rolet.

Të pakënaqur me rolet kjo si shkak i asaj që aktorët gjithmonë ankohen për rolet e veta. Këtu e shoh një substancë të bukur dramaturgjike që qarkullon te audi-

enca dhe njihet nga këto nëntekste falë syçeljes regjisoriale, e cila i jep ritëm të brendshëm psikik veprës. Gjithçka fokusohet në regji e cila është kureshtje dhe trysni. Të gjithë disi i shfaqin brengat me rolet, dëshirojnë t'i luajnë ashtu si duan ose si kanë dëgjuar për ta, t'i përshkojnë, t'i provojnë larmit e tyre dhe zemra e tyre tërhiqej shumë nga kjo. Ata e dinë se mbretërojnë në të përkohshmen derisa regjisori beson në të përjetshmen, dhe ata duan të krijojnë fotografi të cilat nuk i shkojnë konceptit të regjisorit Selmani. Ai ndihmohet nga Faris Berisha, i cili përdoret si xhoker për të gjitha rolet. Vesh kostumet me atlete "Nike". Kjo ndoshta ajo se regjisorët gjithçka bëjnë vetëm për zëvendësim të aktorëve. Donika Ahmeti, dramaturge e shfaqjes, e cila vazhdimisht reflekton mllëf, shkak është teksti i cili nuk u përshatet mirë aktorëve në skenë. Regjisori Hysaj ka ndërhyrë në tekstin e Thomas Uhincop të shkruar më 1747. Ky është një problem te çdo lexim regjisorial dhe disa regjisorë mendojnë se mund të shtojnë tekst mbi trupin e veprës, rivendosin idetë e tyre, ndërsa pala tjetër nuk e cenon tekstin, dakordon theksat regjisoriale. Hysaj ka aplikuar atë të parën, aty kemi tekst të shtuar, veçanërisht kur aktorët i refuzojnë kërkesat e regjisorit. Aty çdo batutë është përtokë dhe e zakonshme.

A ka bërë mirë Hysaj? Unë u ndjeva mirë dhe pashë një dimension të inskenimit, një realitet banal që e jetojmë, shprehje vulgare që i përdorim sidomos kur përmendim organe gjenitale mashkullore dhe femërore. Ato shprehen direkt nga aktorët. Realiteti i sotëm pushtohet nga intriga, gënjeshtria dhe dashurinë

e përdorim si abuzim, ndërsa lirinë si cenim. Ende nuk jemi të lirë, jemi të uzurpuar dhe kjo bukur del në këtë shfaqje. Kjo ishte e trishtë, e zymtë dhe pikëlluese. Tekstin e ri të regjisorit e shoh si mbulesë që i rrinte mirë shfaqjes, sidomos kur vinin batutat komike hera-herës pavarësoheshin nga ajo dramaturgjia poetike-monotone, për publikun e sotëm televiziv. Kalonte edhe në dramë psikologjike dhe depërtime shpirtërore.

### Historia dramatike

Aktrimi i drejtuar nga gratë hysterike, si Teuta Krasniqi, e cila fillim, zhvillim dhe përfundim vetëm bërtet dhe ruan atë elegancën dhe bukurinë fizike. Asaj i pengon ta ndërpresin gjatë interpretimit në skenë, fut edhe elemente nga vetja jo nga personazhi në momentin kur e godet partnerin në skenë. Disa nga gjestikulationet private të cilat i shkojnë personazhit. Edona Reshitaj ka tone psikologjike, ajo e di tekstin e gjithë aktorëve në skenë. Sheqerie Buçaj shfaq elemente dramatike, një rol të bukur dhe të vështirë për t'u mbrojtur. Ajo kishte forma rrëfimi dhe i jepte hijeshi shfaqjes si në lëvizje dhe diksion. Teksa ajo tregon histori dramatike zhvillon forma vizive, jep dramë psikologjike, sidomos kur merr thikën dhe tenton të vetëvritet. Këto elemente makabriteti bëhen më spektakolare për ta lexuar më mirë ngjarjen dhe biografinë e personazhit.

Ajo kishte veprime skenike aktive dhe mizanskena e saj ishte shumë interesante, sidomos kur kostumin e saj e vesh Edona Reshitaj dhe fillon të interpretojë rolin e saj, dramaticiteti pleksej me komiken. Atëherë, Reshitaj tërhiqet, krijon një mizanskenë të

ngadalshme të tërheqjes dhe për asnjëherë nuk e ul dinamikën. Ismet Azemi në rolin e Sulltan Muratit II interpreton me një univers të dukjes, formës dhe shpirtit. Mirëpo, regjisori e pengon, sepse kërkon që Murati II të zhvishet, të kërcej "striptiz", ai këtë gjë e refuzon dhe do ta braktisë rolin. Këmbëngulësia e regjisorit vazhdon dhe ajo kërkesa më ekstreme që Murati II të pran-goset në kafaz, një gjë të cilën as historia nuk e njeh. Ose do vepr-ojë si do regjisori ose duhet ta lërë rolin. Që të mos përjashtohet, ai i bindet regjisorit. Skenografia e krijuar nga Mentor Berisha zhvillohet brenda konceptit të regjisorit. Është teatrale aty ku ndodhin betejat dhe luftërat.

E përzier përmes dy kohësh të sotme dhe të shek XV. I tërë dekor-i ishte lëvizës, kuajt artificialë, njëri i bardhë e tjetri i zi, shër-benin si koncept i ndërrimit dhe vetë regjisori deklaroi se edhe kuajt do t'i ndërrojë, do t'i fusë origjinalë. E mirë ishte ajo se çdo shabllon i krijimit të roleve është si sëmundje ngjitëse, dhe regjisori teton të na lirojë nga kjo. Disa aktorëve në skenë ajo u ngjitej si ndryshku. Sepse, Skënderbeun te ne gjithmonë e inskenojnë dhe luajnë shabllon. E shablloni kur i gjen vend vetes ai shumëohet, ngjitet më shumë dhe e pushton aktorin në të gjitha rolet. Shablloni nganjëherë na plotëson, por më e keqja është atëherë kur aktori nuk ndjen asgjë për rolin dhe e përdor shabllonin, i cili e pengon rrugën e ndjenjës. Në shfaqje si në çdo tjetër ka aktorë zanatçinj, të cilët kombinonë shabllonet. Ka nga ata që nuk i kuptojnë rolet pa i luajtur, më kot i dërgojnë, i kuptojnë vetëm kur i shohin, e atëherë kapin atë siluetën e shabllonit. Shfaqet monotonia e karakterit.



III TEATRI KOMBËTAR I KOSOVËS  
NATIONAL THEATRE OF KOSOVO  
Thomas Whincop & Fadil Hysaj  
**SKENDERBEU  
OSE DASHURI  
DHE LIRI**  
Regjia: FADIL HYSAJ

Skenografia: Mentor Berisha Kostumografia: Yllka Brada  
Kompozitor: Valton Beqiri Ass. regjije: Astrit Bytyqi  
Luftat skenike: Sadik Krasniqi Skulptor i shfaqjes: Artan Hasani  
Aktorët: Bujar Ahmeti, Shpëtim Selmani, Dibran Tahiri,  
Ismet Azemi, Armend Baloku, Sheqerie Buçaj, Teuta Krasniqi,  
Donikë Ahmeti, Vjosë Tasholli, Faris Berisha, Bislim Muçaj,  
Shpejtim Kastrati, Edona Reshitaj, Afrim Muçaj, Naim Berisha,  
Adhurim Demi, Fatime Sefaj Lajçi, Xhejlane Godanci,  
Ramadan Malaj, Dren Arifi, Drilon Tullari, Don Shala  
Balerinët: Fatmir Smani, Kreshnik Musolli, Teutë Krasniqi,  
Jeta Musolli, Aulonë Nuhiu, Ilir Krasniqi

E rrallë

# Pitoni gjendet me 500 rriqra në trup, trajtohet për anemi

Një gjarpër i gjetur me 500 rriqra në trup është në gjendje të rëndë shëndetësore dhe vuan nga anemia. Pitoni u gjet në një pishinë në oborrin e një shtëpie në "The Gold Coast", Queensland, javën e kaluar.



Zvarraniku, i quajtur Nike, u trajtua nga veterinerët për infeksion të rrezikshëm.

FOTO E DITES



Dy persona shihen duke pastruar borën afër një çatie në Lofer të provincës austriake të Salzburgut /AP/

E jashtëzakonshme

# Gruaja besohet e vdekur, por zgjohet në morg

Një ngjarje që t'i futë dridhmat ka ndodhur në një qytet në Rusi. Një grua 62-vjeçare u shpall e vdekur dhe u transferua në morg. Policia ka vërtetuar vdekjen pa kërkuar ndihmën e mjekëve. Megjithatë sapo u transferua në morg, një punonjës i spitalit iu afrua për t'i vënë një tag në këmbën e



kufomës dhe këmba lëvizi e gruaja hapi sytë. "U ngjall", tregon mjeku në gjendje shoku, që menjëherë njoftoi kolegët e tjerë.

**BARSOLETA E DITËS**



**Burri i thotë gruas:**  
- Nëse s'do të kisha ty do të humbisja.  
**Gruaja:**  
- Kaq shumë më dashuron?  
**Burri:**  
- Jo, por nuk e di rrugën për në shtëpi.



**Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC**


Në ora 16:00

**"THE GRINCH" 3D,**

I Animuar/Komedi/Familjar; 1 ore 30 min

Rolet: Benedict Cumberbatch, Rashida Jones, Kenan Thompson, Cameron Seely, Angela Lansbury, etj.

Regjia: Scott Mosier, Yarrow Cheney



Në ora 17:30

**"THE NUTCRACKER AND THE FOUR REALMS" 3D**

Aventure/Fantazi/Familjar; 1 ore 39 min

Rolet: Keira Knightley, Mackenzie Foy, Eugenio Derbez, Mathew Macfayden, Helen Mirren, Morgan Freeman, etj.

Regjia: Lasse Hallstrom, Joe Johnston



Në ora 19:30

**"MORTAL ENGINES" 3D,**

Komedi; 1 ore 51 min

Rolet: Hugo Weaving, Hera Hilmar, Robert Sheehan, Jihae, Ronan Rafferty, Leila George, Patrick Malahide, Stephen Lang, etj.

Regjia: Christian Rivers



Në ora 22:00

**"HUNTER KILLER",**

Aksion/Aventure/Fantazi; 2 ore 08 min

Rolet: Gerard Butler, Gary Oldman, Common, Linda Cardellini, Toby Stephens, Michael Nyqvist, Caroline Goodall, etj.

Regjia: Donovan Marsh



**Për informata dhe rezervime të biletave thirrni FALAS: 0800 22 222 dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.**



**DASHI**

Nëse çdo gjë që do të bëni sot nuk do ta bëni me zemër, sigurisht se nuk do të vlerësohet nga të tjerët.



**DEMI**

Duke qenë se nuk i pëlqeni pasiguritë, sot do të jeni ju që do të merrni një vendim për një person që ju qëndron pranë.



**BINJAKËT**

Ato që për të tjerët duken probleme të mëdha për ju janë thjesht ngecje të vogla që do të arrini t'i zgjidhni menjëherë.



**GAFORRJA**

Sot duhet të mbani një qëndrim të caktuar lidhur me një çështje që ka përfshirë shumë persona si familjarë ashtu edhe miq.



**LUANI**

Sot duhet ta lini mbrëmjen e lirë sepse një ftesë e papritur që mund t'ju vijë duhet ta ketë të gjithë vëmendjen tuaj.



**IRGJËRESHA**

Do të mbani qëndrime reciproke ju dhe një kolegu juaj lidhur me një debat që ka kohë që po zgjat.



**PESHORJA**

Nëse mendoni se me kohën një dëshirë juaj do të realizohet, gaboheni. Duhet edhe impenjimi juaj për t'i realizuar gjërat.



**AKREPI**

Jeni shumë aktiv kohët e fundit në fushën e ndjenjave dhe kjo gjë po i pëlqen partnerit ose personit që po frekuentoni për momentin.



**SHIGJETARI**

Megjithëse me fjalët jeni shumë të zotë, janë veprat ato që do të bindin dikë nëse ju jeni vërtet i aftë apo jo.



**BRICJAPI**

Duhet të hiqni dorë përfundimisht nga ato gjëra që në një mënyrë ose në një tjetër mund ta cenojnë karrierën tuaj në të ardhmen.



**UJORI**

Sot jeni të kapluar nga një mori ndjenjash të kundërta me njëra-tjetrën dhe kjo do të sjellë edhe një gjendje të plogësht gjatë gjithë ditës.



**PESHQIT**

Nuk duhet të keni drojë t'i shfaqni idetë tuaja sot. Do të keni vlerësime edhe nga kundërshtarët tuaj në biznes.

**EURO GLASS**  
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON  
Enveri

Adr: Fushë Kosovë  
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336  
E-mail: euro.glass@live.com



**QENDRA SPORTIVE**  
"BUJQËSIA"  
TEL: 045/82 82 82

PROGNOZA SPORTIVE

SOUTHAMPTON - DERBY

1

ST ETIENNE - MARSEILLE

1

BENFICA II - ACADEMICO VISEU

3+

# Shteti kishte obligim ta ndërtonte Fadil Vokrrin

Ministri i MKRS-së, Kujtim Gashi, ka thënë se institucionet e Kosovës kishin obligim që t'i njihej statusi i personit me merita të veçanta Fadil Vokrrit, i cili ka kontribuar shumë për anëtarësimin e Kosovës në UEFA dhe FIFA. "Ne kemi pasur obligim ta marrim këtë vendim pasi që ai ishte një njeri i cili me vepra të mëdha ka lënë gjurmë në futboll, e veçanërisht me kontributin e tij në anëtarësimin e Kosovës në organizatat ndërkombëtare të sportit", ka thënë ministri Gashi



PRISHTINË, 15 JANAR (ER) - Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Kujtim Gashi, të martën e ka pritur në takim familjen e legjendës, Fadil Vokrrit, me ç'rast ia ka dorëzuar vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës përmes të cilit Vokrrit i njihet statusi i qytetarit me merita të veçanta për kontributin e tij dhënë në promovimin e sportit në arenën ndërkombëtare. Ministri Gashi ka thënë se e kanë pasur obligim ta marrin këtë vendim për legjendën Vokrrin i cili ka ndërruar jetë në qershor të vitit 2018. Pas këtij vendimi familjes së Vokrrit i transferohen mjete financiare prej 1 000 eurosh

në muaj. "Qeveria ka marrë vendim që të ndërtojë Fadil Vokrrin t'i njihet statusi qytetar nderi me merita të veçanta për kontributin që ka dhënë në sport, e veçanërisht në futboll dhe natyrisht ta ndajë një pagë mujore. Ne ju kemi ftuar që sot t'ju japim vendimin e Qeverisë, andaj edhe takimi ynë është i veçantë dhe emocional. Gjithë ne që e kemi njohur Fadil Vokrrin krenohemi për angazhimin dhe punën e tij. Ne kemi pasur obligim që ta marrim këtë vendim pasi që ai ishte një njeri i cili me vepra të mëdha ka lënë gjurmë në futboll, veçanërisht me kontributin e tij në anëtarësimin e Kosovës në orga-

nizatat ndërkombëtare të sportit", ka thënë ministri Gashi.

Ndërkaq bashkëshortja e Fadil Vokrrit, Edita, e falënderoi ministrin Gashi për vendimin e marrë si dhe për nderimin që po i bëjnë Vokrrit. "Fadili ka punuar jashtëzakonisht shumë dhe ka qenë i përkushtuar maksimalisht për futbollin e veçanërisht për finalizimin e stadiumit. Po ashtu, falë punës dhe angazhimit të tij Kosova tashmë është pjesë e shumë organizatave ndërkombëtare sportive andaj ju falënderoj për vendimin e marrë si dhe për nderimin për bashkëshortin tim", ka thënë Edita.

## SHKURT

### Milani në garë për Zhegrovën

Reprezentuesi i Kosovës në futboll, Edon Zhegrova, është duke u kërkuar nga disa skuadra të mëdha evropiane. "Sportmediaset" ka raportuar se e fundit në garë për yllin e Kosovës është skuadra italiane AC Milan. Aktualisht 19-vjeçari është pjesë e skuadrës blege, Genk.

### Lëndohet Grezda, mungon një muaj

Futbollisti i Kombëtares së Shqipërisë, Eros Grezda, do të mungojë të paktën një muaj. Kjo vjen pasi lojtari kuqezi i skuadrës skoceze, Rangers, e ka lënduar kavigjiljen. Testet mjekësore kanë treguar se 23-vjeçari duhet t'i nënshtrohet për 30 ditë fazës strikte të rehabilitimit, larg shokëve të skuadrës. Grezda gjatë verës u transferua në skuadrën që drejtohet nga Stiven Gerrard dhe deri tash ka regjistruar tetë paraqitje dhe ka shënuar dy gola.

### Cikalleshi largohet nga Goztepe

Sulmuesi i Shqipërisë, Sokol Cikalleshi, ka ndërprerë bashkëpunimin me skuadrën e Goztepes në Superligën e Turqisë, ku ishte huazuar nga Osmanlispori. Është vetë klubi turk që e bën publik lajmin në faqen zyrtare në "Facebook". Në njoftim shkruhet se me marrëveshje të dyanshme klubi dhe futbollisti kanë vendosur të mos e vazhdojnë më huazimin. Tashmë mbetet për t'u parë se ku do të luajë sulmuesi kuqezi për pjesën e mbetur të sezonit. Osmanlispori, që zotëron kartonin e Cikalleshit, renditet në vendin e gjashtë në Ligën e Parë të Turqisë, pra në zonën "play-off".

### Rrahmani: U largova nga Shqipëria se nuk luajta në Evropian

Futbollisti i Përfaqësueses së Kosovës, Amir Rrahmani, ka treguar arsyen pse u largua nga Kombëtarja e Shqipërisë. Mbrojtësi i Dinamo Zagrebit ka thënë se mospërfshirja në listën e futbollistëve që luajtën në Kampionatin Evropian ndikoi drejtpërdrejt në largimin nga kombëtarja kuqezi. "Isha në ekipin kombëtar të Shqipërisë, por vendosa të luaja për Kosovën. Pashë që nuk do të kisha shumë hapësirë dhe ata nuk më shihnin ashtu siç unë dëshiroja. Isha në përgatitje për Kampionatin Evropian, por nuk mora pjesë në kompeticion. Kjo ishte arsyeja që vendosa të luaj për Kosovën. Mendova: 'Nëse nuk më llogaritën tani, kur do të më llogaritën...'", ka deklaruar Rrahmani.

## Dukagjini arrin marrëveshje me trajnerin Nazmi Rama dhe mbrojtësin Edmond Turku

KLINA, 15 JANAR - Skuadra e Ligës së Parë të Kosovës në futboll, Dukagjini, e ka zyrtarizuar Nazmi Ramën trajner. Marrëveshja në mes të skuadrës

nga Klina dhe trajnerit Rama është për sezonin pranveror. Nazmi Rama më parë ishte i angazhuar trajner në klubin e Trepçës dhe Istogut, ndërsa

është edhe ndihmëstrajner i Përfaqësueses së Kosovës U19. Kryesia e Klubit të Dukagjinit nga Klina, pasi e angazhoi Nazmi Ramën në detyrën e trajnerit, ka

arritur marrëveshje edhe me mbrojtësin e njohur Edmond Turkun. Mbrojtësi në fjalë në të kaluarën ishte pjesë e Besës së Pejës, Trepçës '89 dhe Gjilanit.



## Trajneri i Freiburgut: Abrashi është luftëtari që ka qenë gjithmonë

**FREIBURG, 15 JANAR** - Amir Abrashi u rikthye në fushat e lojës pas shumë kohëve larg tyre për shkak të një dëmtimi afatgjatë dhe shumë të rëndë. Mesfushori kuqezui u aktivizua

titullar në takimin miqësor përballë Mainzit dhe bëri një paraqitje të mirë. Për mediet gjermane ka folur trajneri i Freiburgut, Christian Streich, i cili i ka thurur elozhe Abrashit.

"Luajti sikur nuk ishte dëmtuar. Një luftëtar i vërtetë. Kam vetëm fjalë të mira për të", ka thënë Streich. Abrashi nuk ka luajtur asnjë ndeshje në kampionat këtë sezon dhe me nisjen e fazës

së dytë pritet të jetë titullar i padiskutueshëm te skuadra e Freiburgut. Dëmtimi në gju e ka penalizuar "maratonmakun" e mesfushës së skuadrës gjermane dhe të kombëtares.



## Kahni analizon formën e dobët të Neuerit

**MÜNCHEN, 15 JANAR** - Manuel Neueri nuk ka bërë paraqitje të mira në fazën e parë të kampionatit. Kapiteni i Bayern Munchenit nuk ka qenë ai që jemi mësuar të shohim në vitet e fundit. Arsyet për këtë duket se i di ish-portieri i "bavarezëve", Oliver Kahn. Sezoni i ri nën drejtimin e trajnerit të ri, Niko Kovaç, ka sjellë shumë turbulencë në skuadrën e Bayernit. Një arsye kryesore për periudhën pjesërisht negative që kaluan kampionët e Gjermanisë duket se është Manuel Neueri. Shifrat flasin kundër kapitenit, i cili nuk kishte pësuar kurrë më shumë gola me Bayernin sa në këtë sezon. Ish-portieri i Schalkes tani shihet me lupë nga shumë analistë sportivë duke e cilësuar atë si pikën më të dobët të skuadrës. Një faktor i rëndësishëm për këtë moment jo të mirë është edhe dëmtimi që Neueri pësoi në fillim të sezonit të kaluar. 32-vjeçari humbi sezonin me Bayernin, duke u rikthyer në kohë për Botërorin, ndonëse luajti vetëm një ndeshje miqësore me "pancerat". Trajneri Joachim Low hoqi dorë nga Ter Stegeni, duke i besuar Neuerit çelësat e portës në Rusi. Kronologjia e ngjarjeve që rrodhën më pas janë të qarta për të gjithë: Gjermania u eliminua nga faza e grupeve në Botëror.



Oliver Kahn, i cili ashtu si dhe Neueri ka fituar Ligën e Kampionëve me Bayernin në vitin 2001, ka folur për problemin psikologjik të Neuerit për shkak të dëmtimit që pësoi. "Manueli po vuan një problem mendor. Atë po e gërryejnë mendimet se një dëmtim tjetër do t'i ndodhë sërish. Kjo është normale pas një dëmtimi. Në kokë të vijnë shumë mendime. Nuk duhet të vritem sërish, përndryshe karriera ime do të përfundojë", u shpreh Kahn. Por "Titani", siç quhet ndryshe ish-portieri "bavarez", mendon se Neueri ka ende mundësi për t'u rikthyer në formën e mëparshme. "Ai duhet të mendojë sa më pak për atë çfarë ka ndodhur në të kaluarën. Në situatat kur duhet të vendosë nëse do të hidhet apo jo, duhet ta bëjë

pa u menduar dy herë. Vetëm kështu mund ta mposhtë frikën që ke brenda teje". Një frikë për të cilën Neueri nuk ka folur asnjëherë. I pyetur vazhdimisht për formën e tij, portieri i Bayernit ka mohuar të ketë probleme me shëndetin. "Që nga vera nuk ndiej asnjë shqetësim në krah. Jam stërvitur mirë dhe mendoj se jam në gjendje për të luajtur në nivele të larta", u shpreh Neueri, i cili nuk shfaq asnjë gjurmë të frikës apo pasigurisë. Por, problemet e tij janë të dukshme, mjafton ta kujtohet barazimin 3-3 në shtëpi ndaj Dyseldorfit në fazën e parë të Bundesligës dhe kupton që diçka nuk shkon. Faza e dytë fillon të premtën, Bayerni do të udhëtojë për në Hoffenheim, ku do ta nisë gjuetinë për titullin ndaj Borussia të Dortmundit.

## San Antonio befasohet nga Charlotte

**SAN ANTONIO, 15 JANAR** - San Antonio është mposhtur nga Charlotte me rezultat 108-93. Kjo është humbja e dytë radhazi për skuadrën e Spursit, kurse e rrezikon edhe zonën e "play-off"-it. Aldridge realizoi 28 pikë e 10 rebounde, por që ishin të pamjaftueshme, ndërsa për Charlotten u dallua Walkeri me 33 pikë. Humbet edhe skuadra e Clippersit, që u mund në Los Angeles 121-117 nga New Orleansi, një tjetër rezultat surprizë në ndeshjet e sotme. Miqtë e kontrolluan ndeshjen në pjesën e dytë, ku dhe vulosën fitoren falë 46 pikëve e 16 reboundeve të Davisit. Për kalifornianët u dallua Lou Williams me 26 pikë e 10 rebounde, por që mbetën për statistikë. Edhe skuadra e Bostonit dështon në ndeshjen e radhës, duke u mundur 109-102 nga Brooklyn, me vendësit që dominuan në takim dhe e merituan fitoren. Russell me 33 pikë ishte lider në fushë për Netsin, duke i bërë të



pavlefshme 34 pikët e Tatunit për miqtë. Pa probleme fiton Sacramento, që mundi 115-107 Portlandin, ndeshje ku gjashtë lojtarë të ekipit vendës realizuan mbi 10 pikë (Hield më i miri me 19 pikë). Skuadra e vetme "big" që triumfoi sot është Houstoni, që mundi 112-94 Memphisin, sukses që ngjiti teksanët në vendin e katërt në Perëndim. Një mbrëmje magjike për Hardenin, që realizoi 57 pikë, rekord sezonal për shënuesin më të mirë, ndeshja e tretë këtë sezon që

realizon mbi 50 pikë. Ndërsa Utah Jazzi mundi 100-94 Detroit, ndeshje me luhate nga të dyja ekipet, ku në fund diferencën e bëri Mitchell me 25 pikë.

### REZULTATET

Brooklyn - Boston	109-102
Houston - Memphis	112-94
San Antonio - Charlotte	93-108
Utah Jazz - Detroit	100-94
Sacramento - Portland	115-107
Clippers - New Orleans	117-121

### SHKURT

#### Ferrari kërkon djalin e Schumacherit

Mick Schumacher, djali i shtatë herë kampionit të botës në Formula 1, Michael Schumacher, është gati t'i bashkohet skuadrës italiane të Ferrarit, duke filluar që nga ky sezon. Në fakt, nuk bëhet fjalë për të pilotuar në garat e Formulës 1, ku tashmë skuadra italiane i ka zgjedhur pilotët e saj dhe ata do të jenë Sebastian Vettel dhe Charles Leclerc. Megjithatë, Mick Schumacher pritet të bëhet pjesë e Ferrari Driver Academy dhe të jetë një nga dy pilotët që do të garojnë në testet zyrtare të skuadrës italiane. Lajmi është bërë me dije nga mediet italiane dhe, ndër të tjera, theksohet ajo çka Arrivabene kishte thënë më herët, se dyert e Ferrarit do të jenë të hapura për një të familjes Schumacher.

#### Chelsea kërkon 150 milionë për Hazardin

Ylli i Chelseat, Eden Hazard, gjithnjë e me shumë po lidhet me një transferim në Real Madrid. "Daily Telegraph" zbulon se Chelsea tashmë ka vendosur se ylli belg mund të largohet vetëm për një shifër prej 150 milionë eurosh.

#### Kabashi huazohet te Gaisi

Sulmuesi nga Kosova, Arian Kabashi, është larguar nga Elfsborgu për të kaluar në Suedi. Sulmuesi 21-vjeçar u largua nga Elfsborg për t'u transferuar te Gais, që aktualisht është në ligën e dytë. Kabashi do të jetë i huazuar deri në fund të sezonit te skuadra suedeze për t'u rikthyer në verë sërish te Elfsborgu. Klubi suedez dëshiron që sulmuesi të marrë më shumë përvojë, andaj e ka huazuar te rivali i tyre nga liga e dytë.

#### Cech pensionohet në fund të sezonit

Portieri i Arsenalit, Petr Cech, ka njoftuar se ky është sezoni i tij i fundit si futbollist profesionist. Përmes një postimi në rrjetet sociale ai ka dhënë lajmin që pak a shumë pritej në fund të këtij sezoni. 36-vjeçari këtë sezon është në stol, pasi Bernd Leno i ka zënë vendin e titullarit. "Ky është sezoni im i 20 si një lojtar profesionist dhe kanë qenë 20 vjet nga kontrata ime e parë si i tillë. Kështu që do të doja ta lajmëroja tërheqjen time nga futbollin në fund të këtij sezoni. Kam luajtur për 15 vjet në Premierë Ligë dhe kam fituar çdo trofe të mundshëm. Ndihej sikur kam arritur gjithçka që kisha objektiv. Do të vijoj të punoj fort tek Arsenali, për të fituar edhe një trofe tjetër këtë sezon, më pas do të shoh se çfarë do të më rezervojë jeta jashtë fushës", ka thënë Cech.

#### Klitschko: Rikthehem në ring vetëm për Joshuan

Revista e famshme "Sports Illustrated" ka hedhur poshtë mundësinë e rikthimit në ring të boksierit ukrainas Wladimir Klitschko për të dueluar ndaj britanikut Dillian Whyte. Ish-kampioni i botës në peshën e rëndë, tashmë 42-vjeçar, mund të rikthehet në ring vetëm për një duel të madh, atë ndaj Anthony Joshuas. Ky i fundit do t'i mbrojë titujt kampionë bote në peshën e rëndë më 13 prill, në stadiumin "Wembley". Klitschko, 64 fitore e 5 humbje në karrierën e tij, zyrtarisht u tërhoq nga sporti në gusht të vitit 2017, 3 muaj pas humbjes ndaj Anthony Joshuas. Ndërkohë që, më parë pat humbur edhe duelin me Tyson Furyn (nëntor 2015), ku dorëzoi edhe titujt kampionë bote, që i mbante prej 10 vjetësh. Ukrainasi nuk preferon një duel ndaj një boksieri "anonim". Sipas tij, po kërkon një sfidë të madhe, siç është ajo ndaj Joshuas, rivali i tij i fundit. Mësohet se Wladimir Klitschko ka raportuar te mediat se lajmi i një dueli të tij me Whyte është një "fake news" (lajm i rremë). Klitschko, kampion olimpike me Ukrainën në "Atlanta 1996", ka mbajtur të gjithë titujt kampionë bote të peshës së rëndë, në kategoritë IBE, IBO, WBA e WBO.



MINISTRIA E KULTURËS, RINISË DHE SPORTIT

MINISTARSTVO ZA KULTURU, OMLADINU I SPORTA/ MINISTRY OF CULTURE YOUTH AND SPORTS

DEPARTAMENTI I FINANCAVE DHE SHËRBIMEVE TË PËRGJITHSHME/ DEPARTMENT OF FINANCES AND GENERAL SERVICES/ DEPARTMAN I FINANSIJA I GENERALNIH USLUGA

DIVIZIONI I BURIMEVE NJERËZORE/ DIVISION OF HUMAN RESOURCES/ DIVIZIJA LJUDSKIH IZVORA

Bazuar në Ligjin për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-149 dhe Rregulloren Nr. 02/2010, për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit shpall:

## KONKURS

Titulli i punës: Asistent Administrativ

Institucioni: MKRS-Prizren

Kategoria funksionale : Koeficienti: 6

Numri i referencës: 02/2019

I përgjigjet: Udheheqesit të divizionit të IT dhe Shërbimeve të Përgjithshme

Vendi: Prizren

Lloji i kontratës: "Marrëveshje për shërbime të veçanta" (kohëzgjatje 6 muaj)

Detyrat dhe përgjegjësitë: Nën mbikëqyrjen e, Udheheqesit të Divizionit të IT dhe Shërbimeve të Përgjithshme kryen këto detyra dhe përgjegjësi:

1. Ndihmon stafin Profesional dhe Drejtues në një numër të detyrave të rëndësishme dhe të shkathëta teknike/administrative, (shpesh pa mbikëqyrje) dhe kryen të gjitha punët në kohë dhe në mënyrë të saktë ;
2. Merr përgjegjësi specifike, pa mbikëqyrje, për interpretimin dhe zbatimin e një numri të procedurave dhe udhëzimeve administrative përmes vet-iniciativës, kur kërkohet një gjë e tillë, përfshirë trajtimin e rregullt, në mënyrë të pavarur të çështjeve të parapara me udhëzime, por të ndërlidhura me institucionin;
3. Mban regjistër të saktë dhe të plotë të aktiviteteve, dosjeve, punimeve, dokumenteve zyrtare , etj., përfshirë përgatitjen e raporteve të detajuara dhe të komplikuar dhe analizave statistikore;
4. Mund të kërkohet të mbikëqyrë stafin më të ri dhe koordinon/konsolidon dhe verifikon punën e tyre;
5. Mban kontakte të rregullta me punonjësit në të gjitha nivelet e institucionit, stafin e institucioneve tjera dhe publikun, përfshirë ofrimin e ndihmës dhe këshillave e udhëzimeve për çështje të caktuara, ose shkëmbim të informatave;
6. Ndihmon në adresimin e pyetjeve nga menaxherët dhe stafi, në lidhje me procedurat teknike ose administrative të cilat mund të jenë mjaft të komplikuar;
7. Kryen detyra tjera në përputhje me ligjet dhe rregulloret aktuale të cilat mund të kërkohen në mënyrë të arsyeshme kohë pas kohe.

### Shkollimi i kërkuar, përvoja, aftësitë dhe karakteristikat personale:

1. Aftësi për zbatimin e procedurave dhe udhëzimeve administrative, për kryerjen e detyrave të punës.;
2. Shkathhtësi komunikimi, përfshirë aftësinë për të interpretuar informata, dhënë udhëzime dhe përcjellë informata tek të tjerët;
3. Aftësi koordinimi dhe mbikëqyrje të punës së personelit në nivelin administrativ dhe teknik;
4. Shkathhtësi kompjuterike në aplikacione të programeve (Word, Excel, Power Point, Access);
5. Arsimitim i mesëm, trajnim përkatës dhe së paku një vit përvojë pune, në fushën përkatëse teknike ose administrative.

Procedurat e konkurrimit: Konkursi është i hapur për të gjithë kandidatët.

Kohëzgjatja e emërimit: Emërimi është me afat të caktuar.

Data e mbylljes së konkursit: Konkursi është i hapur tete (8) ditë pas ditës së shpalljes.

Data e fundit e aplikimit është: 23.01.2019

Aplikacionet e dërguara nëpërmjet postës, me pullë postare, në ditën e fundit të shpalljes, konsiderohen të vlefshme.

Paraqitja e kërkesave: Aplikacioni merret dhe dorëzohet në zyrën 27 të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Adresa: Sheshi "Nëna Tereze" Nr. 44. Për informata shtesë kontaktoni në numrin 038211449 dhe 038 211921, ( apo në ueb-faqen <http://www.mkrs-ks.org>).



MINISTRIA E KULTURËS, RINISË DHE SPORTIT

MINISTARSTVO ZA KULTURU, OMLADINU I SPORTA/ MINISTRY OF CULTURE YOUTH AND SPORTS

DEPARTAMENTI I FINANCAVE DHE SHËRBIMEVE TË PËRGJITHSHME/ DEPARTMENT OF FINANCES AND GENERAL SERVICES/ DEPARTMAN I FINANSIJA I GENERALNIH USLUGA

DIVIZIONI I BURIMEVE NJERËZORE/ DIVISION OF HUMAN RESOURCES/ DIVIZIJA LJUDSKIH IZVORA

Na osnovo Zakona o Radu, br. 03/L-212, Zakona o Civilnoj Službi Republike Kosovo, br. 03/L-149, Pravilnika br. 02/2010 o procedurama zapošljavanja pri Civilnoj Službi Republike Kosovo, Ministarstvo za Kulturu, Omladinu i Sport objavljuje:

## KONKURS

Naziv radnog mesta: Administrativni Asistent

Institucija: MKOS-Prizren

Funksionalja kategorija: Koeficient: 6

Broj referencije: 02/2019

Nadzornik: Rukovodiocu Div. IT i generalnih Usluga

Mesto: Prizren

Vrsta Ugovora: „Sporazum o posebnim uslugama“ (Vremenski rok 6 meseci)

Dužnosti i odgovornosti: Pod nadzorom Rukovodiocu Div. IT i generalnih usluga, ispunjava sledeće dužnosti i odgovornosti:

1. Pomaže stručnom i rukovodećem osoblju za broj važnih i tehničko/ administrativnih dužnosti, obično radeći (često i bez nadzora) i odgovara za rokove i tačnost svog posla ;
2. Preuzima specifičnu odgovornost, bez nadzora, za interpretaciju i sprovođenje broja procedura i složenih administrativnih uputstava i to putem samo-inicijative kada se to traži, uključujući redovno tretiranje predviđenih pitanja koja zahtevaju primenu rasuđivanja prema urdebih, ali u vezi institucije ;
3. Vodi tačan i potpun registar aktivnosti, predmeta, radova, službenih dokumenata, itd., uključujući i pripremu detaljnih i složenih izveštaja i statističkih analiza;
4. Po zahtevu, nadzire novo osoblje, određuje ciljeve, pruža uputstva, savete i obuke, koordiniše/konsoliduje i proverava njihov rad;
5. Održava redovne kontakte sa zapošljenima na svim nivoima institucije, visokim službenicima, osobljem drugih institucija i javnošću, uključujući i pružanje pomoći i saveta i uputstava za određena pitanja ili razmenu informacija;
